

E

BIBLIOTEKA

814-32

H 29

SHTETIT

GJIROKASTËR

45
*minuta
mbi çati*

TREGIME

DYLBER HASANI

8P/P 83-32

H 2 P

DYLBER HASANI

S

45 MINUTA MBI ÇATI

T r e g i m e

1090

~~54563~~



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

UNË, HABIBI DHE BRIGADIERI

Ishte rrokullisur kapaku e kishte gjetur tenxheren: ja, si ishim puqur me njëri-tjetrin unë dhe Habibi. Megjithëse ai ishte nga veriu dhe unë nga jugu, kush na shikonte së bashku, mendonte se ishim rritur bashkë e nuk ishim ndarë ndonjëherë nga njëri-tjetri... Po të afroheshe pranë objektit që po ndërtonin, do të kujtoje se aty bëheshin prova për ndonjë festival folkloristik: gjithë ditën kënga vinte gjym! Zakonisht mëngjezeve unë e Habibi ja fillonim me ndonjë këngë nga Shqipëria e Mesme, pastaj hidheshim në këngët e veriut; ai këndonte, kurse unë ja bëja dingërdang me gojë (imitoja çiftelinë); ndërsa aty nga mesdita uleshim këmbëkryq mbi skelë dhe ja merrnim labçes, sa oshëtinte dhoma ku suvatonim! Aq na rrëmbente kënga, sa harronim se ndodheshim në skelë me mistri në dorë, e na dukej vetja se po jepnim shfaqje për publikun mbi ndonjë podium!..

Kur vinte brigadieri e na gjente ashtu, ulur këmbëkryq duke kënduar për shtatë palë qejfe, na fliste në fillim me të urtë, pastaj çirrej e bërtiste me sa kishte në kokë. Po ne i aktivizonim më shumë gurmazet, sa ai tërhiqej, hë për hë, i thyer

nga fusha e betejës! Po kjo thyerje ishte e përkohshme për të, sepse, bëri ç'bëri dhe na ndau më në fund nga njëri-tjetri: na veçoi në skuadra të ndryshme. Na erdhi plasje, po s'kishim ç'të bënim; nuk i dilej dot brigadierit, aq më tepër se kishte edhe pak të drejtë: ne nuk e shfrytëzonim sa duhet kohën e punës. Por këtë nuk më pëlqente ta pranoja.

Të them të drejtën, u mërzita që më ndanë nga Habibi, prandaj më erdhi mirë, kur një ditë, një nga punëtorët e brigadës, Seit Qyreçi, më hoqi mënjane dhe më tha me zë të ulët: «Kemi ndër mend që ta heqim brigadierin.»

— Po pse?

— E para — më përgjigjet Seiti — ai nuk e shfrytëzon kohën e punës, por sillet vërdallë sa në një skuadër në tjetrën.

«Një në dorë», — thashë me vete, se më pëlqeu ky argument.

— E dyta — vazhdoi Seiti — i mungon aftësia për të organizuar punën.

«Paska kapur pikat kyçe», thashë me vete dhe bëra shenjë aprovimi me kokë.

— Dhe e treta, — vijoi Seit Qyreçi, — është arrogant dhe i pasjellshëm me anëtarët e brigadës.

«I ka rënë më të!», mendova dhe kujtova se ç'na kishte punuar brigadieri mua dhe të shkretit Habib, që na ndau për së gjalli nga njëri-tjetri!

Tanimë për mua ishte çdo gjë e qartë si drita e diellit: këto tri arësye mjaftonin që brigadieri të hiqej e të mos na krekohet më si ai gjeli majë plehut!.. Ishte qerrata i madh ky Seit Qyreçi! Ç'vinde e i pillte mendja!.. Mirëpo flitej se Seitin e

kishin përzënë nga brigada ku kishte qenë më parë, sepse na paskish qenë grindavec i madh, llafazan e intrigant. Kështu flitej për Seitin, po mua sikur nuk më besohej. Seiti sillej mirë dhe të gjithëve na rrinte me dorë në qafë...

Kështu vazhdimisht unë mendoja për ato që më kishte thënë Seiti: shfrytëzimi i tetëorëshit, organizimi i punës, sjellja me punëtorët... A ka brigadieri ynë të meta të tilla? Vrava mendjen, po të them të drejtën, sikur s'po bindesha se qe ashtu. «Ndofta i kanë vënë re të tjerët këto të meta të brigadierit tonë», thashë me vete, sepse ma kishte pak qejfi që ta zinim mat brigadierin. Ah, more brigadier, paç veten në qafë! Të paktën të mos më kishe veçuar nga Habibi!..

— Hë, ç'thua?! — Më shkundi nga mendimet Seiti, duke më shkelur synë.

— Kam frikë se nuk do të na ndezë! — i thashë.

— Ç'ke ti! — ma priti ai duke i rënë gjoksit me grusht. — E rregulloj unë këtë punë, ti vetëm të na japësh votën. Kam biseduar edhe me të tjerë për këtë çështje.

— Po Habibi ç'thotë?

— Edhe ai dakord është, vetëm se pret fjalën tënde.

Epo, s'kisha pse ta zgjatja më tej. Edhe po të mos doja unë, kjo punë, sipas fjalëve të Seitit, paskësh marrë fund. Vetëm për një gjë më hante merakun dhe ja thashë Seitit:

— Po për brigadier, cilin keni menduar?

Sytë e tij bojë hiri sikur u veshën me një lëng të ngjashëm me rrëshirën e pishës. Ai buzëqeshi duke përveshur buzën e poshtme, sa ju dukën një

sërë dhëmbësh të florinjte. «Këtij i hëngërka vetë qafa për këmborë dashi!» — thashë me vete. Ndërkaq Seiti më vuri dorën në sup dhe më pëshpëriti me ëmbëlsi: «Shokët e kanë syrin tek ti. Po shiko, mos i thuaj njeriu tani për tani...»

— Je në vete! — thashë i habitur. — Jo, mor vëlla, nuk e mbajnë dot krahët e mi atë kungull!

— Kështu të duket ty, po shokët kanë të drejtë. Edhe unë mendoj se ti je i vetmi njeri tek ne i përshtatshëm për brigadier.

Kaq tha dhe iku, duke më lënë të shtangur nga habia. Fjalët e Seitit, dalëngadalë erdhën e m'u ëmbëlsuan, sa shprehja «shokët e kanë syrin te ti» nuk m'u hoq nga mendja gjatë gjithë mëngjezit.

Në pushimin e drekës u takova me Habibin. Ai ishte shend e verë. «Sigurisht gëzohet që do të më zgjedhin mua brigadier», mendova i kënaqur. Më shkoi mendja që Seiti, duke e ditur që unë dhe Habibi jemi shokë të ngushtë, do t'ja kishite dhënë lajmin edhe atij. Prandaj tani prisja me zemër të gufuar nga kënaqësia urimet e Habibit. Po ku unë e ku ai!

— Tani do t'ja themi këngës sa të na lodhet gërmazi! — ma priti ai.

— Jo, more! — thashë i gëzuar. — Mos e rregullove me brigadierin, që të na bashkojë prapë?

— Ç'ne, ore! — Më tha kryetari i komitetit profesional se tek ne u ngrit grupi artistik.

— Mirë që e ngritën më në fund — i thashë. — Po brigadierit ama, ja kam vëth në vesh për atë që na bëri... Ke biseduar gjë me Seitin?

— Ohu, ç'e dëgjon dhe ti atë! — ma ktheu Habibi. — Nuk është gjë ajo mesele!

Më erdhi inat me Habibin. Ai s'kishte besim se mua mund të më zgjidhnin brigadier. Sa me qejf e kisha kapur këtë çështje, kurse ai në çast ma përmbysi.

— Po pse, mor vëlla, — i thashë, — mua Seiti ma bëri të mbaruar! ?

— E, mirë, mirë, ashtu të mbaruar ma bëri ai edhe mua, po e mendova punën mirë dhe, të them të drejtën, ato që thotë Seiti për brigadierin janë pesë me hiç, janë qiçra në hell. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt: brigadieri nuk na ka ndonjë faj, apo jo? — më foli ai.

— E, e, ashtu është, po sikur na e ka prishur një çikë qejfin që na ndau...

— Mor, lëre atë. Ato që thotë Seiti për brigadierin mua më duket se s'janë gjë: nuk i ka brigadieri ynë ato të meta, si thua ti?

— Ashtu më duket edhe mua, — i thashë pa qejf. — Po më duket se shokët e kanë gjetiu syrin për brigadier. Më erdhi zor të përmendja emrin tim, të përsërisja ato që më tha Seiti.

— Qiçra në hell! — foli përsëri Habibi. — Shokët e paskan syrin tek unë, kështu më tha Seiti. Po unë nuk do të pranoj që të heqin brigadierin.

— Po Seiti më tha edhe mua që shokët e kanë syrin tek unë — thashë i rrëmbyer, — kështu të paska thënë edhe ty?!

— Ja, se ç'na qenka, — tha Habibi. — Tani po e kuptoj mirë se ku e paska hallin Seit Qyreçi... Po ti e kupton?

— Oj, të kuptuar! — u përgjegja i inatosur dhe thashë, sikur atë çast ta kisha Seitin pranë, do ta

kapja për fyti! — Hajt, pa ka për ta parë ai!..

Nuk thonë kot: po dëgjove daullen, dasmën e ke prapa. Kështu, pas gjithë këtyre që ndodhën, brigadierit tonë na i venë një goxha fletërrufe, që zente tre çerekë të tabelës së madhe, të vendosur për këtë punë. E ç'nuk thuhej në atë fletërrufe! Brigadieri ynë cilësohej si burokrat, mendjemadh, arrogant, dembel e të tjera, e të tjera. Në fund ishte shënuar me gemra të mëdha: Seit Qyreçi.

Nuk vonoi shumë dhe në tabelë pamë një fletërrufë tjetër. Atë e shkruante Liria, një suvatore. Kur e lexoi Seiti atë fletërrufë, i kërcyen sytë si kokrra dardhe. Liria e mbërthente me shpatulla për muri. Ajo e quante intrigant e gënjeshtar. Madje i përmendte edhe origjinën, shkak ky për konceptet e tij të gabuara borgjeze. Seiti rridhte nga një familje tregëtarësh.

Mbledhja e brigadës, për shqyrtimin e fletërrufeve, u bë të nesërmen. Për çudinë time Seiti dukej i qeshur, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Sigurisht shpresonte në ndihmën tonë. «Shokët e kanë syrin tek ti», më pëshpëriti në vesh, kurse Habibit i shkeli syrin me buzë në gaz. Edhe disa të tjerëve, që kishte pranë, u tha në vesh diçka.

— Seit, — i thashë unë me zë të lartë, që ta dëgjonte dhe Habibi, — shokët e kanë syrin te ti.

— Ashtu?! — qeshi Seiti. — Ju falemnderit që keni besim në zotësinë time! Jua shpërblefsha në gëzime!

— Qiqra në hell! — ja priti Habibi.

— E?! — i tha i habitur Seiti.

Por s'mori dot përgjegje, se mbledhja filloi. Hajde «dajak» hajde! As në ëndërr s'e kishte parë Seiti një dush të tillë. Një fytyrë i vinte, një tjetër i shkonte.

— Nuk të thashë kot që të gjithë e kanë syrin tek ti, — i thashë Seitit. Po ai ishte bërë tym fare.

— Ne të dy, ama, për pak e morëm më qafë brigadierin — u ktheva pastaj e i thashë Habibit.

— Jo, more, nuk e hanim kaq kollaj ne atë kokërr ulliri!

Pata një ndjenjë admirimi për te dhe m'u duk vetja mjaft i vogël, por lëkundjet e mia nuk ja thashë atë çast. Kur ja tregova më vonë, ai qeshi me të madhe.

Seitit i dhanë atë që meritonte.

— Hajde tani, merrjani një kënge! — na tha kryetarja e komitetit profesional, kur mbaroi mbledhja.

Dhe unë e Habibi atë prisnim. Ja morëm me gjithë zemër këngës «Revolucioni marshon». Të gjithë na pasuan. Vetëm Seiti rrinte kokëvarur.

NYJA E DJEGUR

Behija i mbylli dhitë në ahur, mbështolli rreth dorës litarin, me të cilin kishte ngarkuar dushkun në shpinë dhe u drejtua për në dhomë. Litarin e la mbrapa derës dhe u ul pranë vatrës që të ngrohej. Nënë Xhikja po thurte çorape, kurse Dilja, nusja e të vëllait, gatuante darkën. Kandili lëshonte një dritë të mekur, sa mezi dalloheshin sendet përreth dhomës. Drutë në zjarr digjeshin duke kërcitur me zhurmë. Muret e rrahura nga tymi e bloza ishin nxirë. Marimangat vareshin si jargë kërmilli nëpër trarët.

Behija i shikonte këto, siç i kishte parë edhe herët e tjera. Ajo kështu e mbante mend gjithmonë këtë dhomë, si të gjithë shtëpinë. Gati edhe jeta e saj ishte e njëjtë. Kujtime të ëmbla për të ishin vetëm ato të vegjëlisë, të jetës shkollore. Pastaj, mbasi kishte mbaruar klasën e katërt, po e njëjta punë: shko me dhi, ngarkohu me dru e me dushk, thur fanella e çorape, gatuaj bukë e ziej fasule.

Një zë u dëgjua që jashtë nga shtegu. Ajo ndjeu hapat e vëllait të madh, Hamdiut, që doli menjëherë.

— Paj, kush thirri, e? — Pyeti nënë Xhikja me habi tek rrinte mbështetur pas murit, në krye të vatrës.

— Ndoj mik, drue — ju përgjegj Dilja.

— Jo, hej, se miku nuk ban za kah shtegu, po hyn drejt e në çardak.

U dëgjua zëri i Hamdiut, që bisedonte me dikë. Dëgjohej edhe një zë i hollë tingëllues, që nuk shembëllente me zë burri. Mbas pak u ndien hapat e vëllait të Behijes dhe hapa të tjerë, pastaj përsëri u dëgjua ai zëri i hollë që pyeste dhe ai i Hamdiut, që, me sa dukej, diç përgjegjej. Dilja ju afrua derës dhe vuri syrin te një e çarë.

— Ndonji e delegueme, — tha nënë Xhikja pa luajtur nga vendi.

— Janë dy, — ja priti Dilja, që u kthye te vendi i saj për të trazuar fasulet në kusi me luginën e drunjtë. — Nga zani m'u dukën si goca, megjithëse kishin pantallona, — shtoi.

Mbas këtyre fjalëve, në dhomën e grave ra heshtja, ndërsa nga dhoma e burrave nisi të vinte gjer atje murmuritja e mbytur e bisedës.

Behija u bë shumë kureshtarë. U mundua të gjente ndonjë shkak për t'ju afruar derës, që të dëgjonte ato që thuheshin. Ju kujtua një nyjë në mes të litarit. Ishte munduar gjatë ditës ta zgjidhte dhe nuk e kishte zgjidhur dot. Ishte orvatur me thonj e me dhëmbë dhe, më në fund, e mërzitur, e kishte lënë. Tani kjo nyjë do t'i shërbente si shkak për t'u afruar te dera që të përgjonte.

Të dëgjuarit tinës në dhomën e burrave, Behijes i qe bërë ves kohët e fundit. Gratë e kishin të ndaluar të shkonin atje, kur kishte njerëz që

s'ishin të shtëpisë. Në qoftë se i ardhuri do të qe ndonjë mik, ato mund të takoheshin me të vetëm me urdhërin e të parit të familjes.

Por Behijes nuk i rrihej pa mësuar se kush kishte ardhur mysafir. Diçka e trondiste, i ndillte një lloj frike, kur në shtëpi kishte miq. Mos kishin ardhur nga ana e?..

— Pse u ngute me e zgjidhë nyjën, Behije, apo ke frikë se t'u ka lidhë fati, a? — E ngacmoi Dilja.

— Mos e luej gocën, nuse! — E qortoi e vjehrra.

Behija u zemërua shumë nga shpotia e së kurnatës.

Saherë i kujtonin «fatin» e saj, dëshpërohej shumë. Pikërisht, shkak i këtij «fati» e kishte shtyrë Behijen kohët e fundit që të përgjonte. Dhe ky «fati» i Behijes kishte një histori më vete.

...Atëhere ajo kishte qenë gjashtë vjeçe. E kalonte kohën duke luajtur me fëmijët e mëhallës. Gëzohej kur i plotësoheshin dëshirat e saj të vogla, kur i blinin ndonjë palë dimite të reja, qante kur rrëzohej, kur i flisnin për ndonjë faj, apo kur i hiqnin ndonjë pëllëmbë. Ishte shumë e hedhur dhe e afruar, sa që i ulej në prehër pa u ndrojtur kujtdo që vinte në shtëpinë e tyre. Ashtu ishte ulur ajo edhe në prehërin e Musa Belikut, që kishite ardhur nga fshati fqinj. E ku e dinte e gjora fëmijë, se tamam ajo sjellje fëminore do ta «lidhte» jetën e saj? Atë mbrëmje, ndërsa Behija fërkonte duart leshtore të mikut me doçkat e saja të njoma qumësht, mysafirit i shkrepri në mendje ta bëjë këtë «keçe» nuse të djalit të tij. I shkrepri

në mendje, e kërkoi dhe e mori fjalën. Për këtë «keçe» gjashtëvjeçare, Musa Beliku i numroi të atit të Behijes, Mersinit, njëzet e pesë mijë lekë.

Mbas një viti Behija hyri në shkollë. Kujdesi i mësueses dhe dëshira që kishte për të mësuar e futën në botën e këndshme të librave dhe të ëndrrave të bukura feminare.

— Ju do të rriteni të lumtur, — u thoshte mësuesja. — Për ju nuk do të ketë më vuajtje, ashtu siç ka pasur për prindërit tuaj.

Dhe Behija ndjehej me të vërtetë e lumtur. Ajo e parafytyronte veten e saj të rritur, mësuese, gjithnjë pranë fëmijëve, që i mblidheshin përreth me respekt e dashuri. Ajo do t'u mësonte abetaren dhe ata do t'ja rrëmbenin fjalët nga goja.

Por, si mbaroi shkollën fillore, jeta e Behijes mori një kthesë.

— Tashti u bane goxha gocë, prandaj duhet me u nda nga shkolla, se je e fejueme, — i thanë.

Dhe ajo, ndonëse kishte shumë dëshirë të vazhdonte shkollën, bëri siç e urdhëruan.

Dalëngadalë, duke u rritur, zuri të mendojë për të fejuarin e saj. Kishte dëgjuar se quhej Pëllumb Beliku. Emri Pëllumb i pëlqente shumë. «Po çfarë njeriu ka me qenë ky Pëllumbi?» — Thoshte, dhe një ndjenjë e huaj, e largët, e frikshme ja pushtonte kraharorin. «Një «pullumb», që nuk ka të bajë aspak me mue...»

Kaluan vite. Moshataret e saj u martuan njëra mbas tjetrës por për Behijen s'po dukej asnjë njeri nga ana e dhëndërrit për të prerë ditën e dasmës. Njerëzit filluan të shikonin me dyshim dhe vajza ulte sytë e turpëruar, ndërsa zemra i ndrydhej në kraharor.

Një ditë i ati u bë si i tërbuar. Vinte vërdallë nëpër shtëpi dhe shante e bërtiste, duke përmendur herë mbas here emrin e Pëllumb Belikut.

E kunata i pëshpëriti Behijes se dhëndri kish-te lajmëruar me një letër se krushqia ndërmjet tyre ishte prishur. «Unë jam anëtar i Bashkimit të Rinisë, thuhej në letër, dhe jam kundra këtyre fejesave... Mua më fejuen kur isha kalama. Ç'bashkëshortë kena me qenë unë dhe Behija, derisa nuk e kena pa, të paktën një herë, njani-tjetrin. Unë e di se ju pleqve ka me ju ardhë randë nga ky veprim, por Behija besoj se ka me më kuptue drejt e nuk do t'i ngelet hatri. Sa për paret që keni marrë nga im atë, mos u bani merak, ju bafshin mirë dhe qofshi të gëzuem!»

Behija vështroi për disa çaste e habitur kunatën, pastaj uli sytë pa qenë në gjendje të mendojë gjë. Nuk dinte as vetë ç'ndjente. Më tepër se dhimbje, atë e pushtoi një ndjenjë turpi, turpi që do të quhej vajzë e braktisur. Por thellë në shpirt i bëhej se Pëllumbi e kishte shpëtuar nga një ankth, që e mbërthente saherë mendonte për martesën e saj, për fatin e saj në shtëpinë e burrit. Ajo u mërzi pak, po kjo ndjenjë i kaloi. Ajo u çlirua nga një barrë e rëndë. Asnjë gjurmë dashurie nuk kishte në shpirtin e saj, dhe lëndimi i ndërgjegjes do të shuhej shpejt. Vetëm i ati shpërthente si furtunë, ja shfrynte inatin kujt të mundte dhe pinte tri kuti duhan në ditë. I vëllai i madh, Hamdiu, e kërcënonte atë që u lëshoi këtë turp në shtëpinë e tyre. Ndryshe qëndronte puna me vëllain e vogël, Besimin. Ai e quante me vend veprimin e Pëllumbit. Nënë Xhikës i bëhej zemra

copë dhe nuk guxonte të dilte në sy të mëhallës, kur mendonte se, mbas kësaj, vajza do t'i mbetej në shtëpi. Kurse e kunata herë mbas here e tërthorazi ja ngulte ndonjë thumb.

... Nyja e litarit i mbeti në dorë Behijes, atje tek rrinte prapa derës. Ajo e shtypte ngadalë me gishtërinj, sikur të prekte ndonjë dhëmballë të sëmurë. E tërhoqi biseda që zhvillohej në dhomën e burrave ndërmjet të zotërve të shtëpisë dhe dy vajzave që kishin ardhur mysafire. Dëgjoi se njëra nga vajzat quhej Shpresa dhe tjetra Burbuqe, se ato kishin ardhur së bashku me njëzet e tetë shokë dhe shoqe të tjera, që të punonin pesëmbëdhjetëditë në kooperativë, për të ndihmuar në hapjen e tokave të reja kooperativën e re malore.

Ja kishte ënda të takohej me shoqet e ardhura nga qyteti, por druhej se mos i bërtiste i ati. Megjithëse nuk njihte asnjërën prej tyre, nga fjalët që dëgjoi, i pëlqeu më shumë Burbuqja. Ajo fliste aq thjeshtë e me ngrohtësi, saqë Behijes i dukej sikur ishte në zemrën e saj. Biseda, që kishte nisur për problemet e kooperativës së re, kishte kaluar te lufta për zhdukjen e mbeturinave fetare e zakoneve prapanike dhe të atyre zakoneve të këqia që e kishin lënë gruan dhe vajzën prapa. Xha Mersini dhe Hamdiu mbronin zakonet, por vajzat, sidomos ajo Burbuqja, me arësytimet e saj, i zinte ngushtë, saqë s'kishin ç'të thoshin. Besimi më të rrallë lëshonte nga një fjalë, ashtu si padashje, veçse ato fjalë zemëronin të atin dhe Hamdiun, ndërsa vajzat vinin buzën në gaz dhe i jepnin të drejtë.

— Këtej e tutje — tingëlloi zëri i Burbuqes

— gratë nuk do të jenë më skllave të këtyre zakoneve, që i kanë poshtëruar. Kjo është detyra që shtron partia, prandaj është detyra jonë dhe, në radhë të parë, është detyra e burrave, e baballarëve, e vëllezërve...

Po të arësyetosh drejt, xha Mersin, si i thonë, me dorë në zemër, — vazhdoi ajo, si gratë, si burrat, si djemtë, si vajzat, të gjithë njësoj janë, prandaj njësoj duhet të trajtohen. Ju, për shëmbull, gruan e keni njeriun më të afërt. Me atë keni jetuar, keni punuar, keni përballuar vështirësitë e jetës, keni ndarë gëzimet dhe hidhërimet. Vajzat janë gjaku juaj, i keni rritur... — Ajo deshi të shtonte edhe diçka tjetër, po në dhomë u ndien hapat e Diles. U hap dera dhe u duk gjysma e tepsisë me bukën e gjellën e darkës. Kështu ishte zakoni: njëra nga gratë e sjell bukën deri te dera, pastaj ngrihet njëri nga burrat dhe e shtron në sofër.

— Ecë, oj nuse, mos ki turp, se edhe këto vajza si ti janë, ani se kanë veshë pantallona, — i foli Besimi së kumatës, pa u merakosur nga veshtrimet e zemëruara të plakut.

Dilja u mat të hynte, po u tërhoq në çast. Duhej fjala e vjehrrit. Burbuqja u ngrit menjëherë dhe ju afrua derës.

— Nga ne druhash, moj motër? — I dha zemër Diles, që qëndronte me tepsi në dorë.

— Ja... kështu, kështu e ka zakoni, — ju përgjegj ajo gati me një psherëtimë.

— Çfarë zakoni, moj?! Ne do t'i hedhim në kosh të gjitha këto mbeturina, që na kanë ngatë-

rruar këmbët, — ja priti Burbuqja rrëmbyeshëm e gati — gati si me qortim.

Dilja, e nxituar nga fjalët dhe vështrimet e mysafires, kaloi prakun e derës. Dera mbeti e hapur. Burbuqja hodhi sytë matanë. Prapa kanatit dalloj Behijen, që rrinte si e hutuar me litarin në dorë. Ajo akoma shtrëngonte me gishtërinjtë nyjën. Në gjysmëerrësirë, mysafirja vuri re tiparet e bukura të malësores. Drita e kandilit nga dhoma e grave dhe ajo e llambës së vajgurit nga dhoma e burrave ndesheshin në faqet e saj të shëndetshme, në ngjyrë trëndafili. Burbuqja e zuri për dore, e tërhoqi pas vetes dhe u fut bashkë me të në dhomë.

— Rrinte te dera dhe nuk guxonte të hynte brenda — i tha Shpresës. — Po këtë litar, pse e mban në dorë? — Ju drejtua Behijes.

— Desha me zgjidhë nyjën, por nuk mujta...

— Nyjën, ë? — Burbuqja vuri buzën në gaz. Ajo kishte dëgjuar për këto bestytnitë, për nyjën, për «fatin». Por, duke parë tani litarin në dorën e malësores, atë litar që ishte bërë pjesë e pandarë e jetës së vajzës dhe gruas, e jetës së rëndë, menjëherë sytë i shkrepëtinë.

— Nuk e zgjidhe dot? — Përsëriti. — Mirë, ma jep mua. Kjo nyjë duhet djegur në zjarr.

Burbuqja mori për nga vatra, me fytyrën të ndezur. Ajo nuk mendoi në ato çaste as xha Mer-sinin, as Hamdiun, që po e vështronin të habitur. Një zemërim, një urrejtje e papërmbajtur e shtyn-te drejt vatrës.

— Mos, se nesër i duhet litari përsëri, — kërcëu Hamdiu.

— Nuk do t'i duhet, se s'ka për t'u ngarkuar më, — u përgjegj e vendosur Burbuqja dhe, ndër-sa zgjati dorën për ta hedhur në zjarr, shtoi: — I ndarë më dysh, litari do të jetë më i volitshëm për kafshët e shtëpisë.

— Buqe, prit një minutë, — e ndaloi Shpresa. — Ta djegë vajza me dorën e saj.

— Shumë mirë — Burbuqja i zgjati litarin Behijes. — Merre dhe përvëloja kokën, nxirrja inatin, sepse të ka mbajtur lidhur kaq kohë.

E tërhequr nga tërë kjo lëvizje e gjallëri, në derë u duk nënë Xhikja me shtizat dhe lëmshin e penjëve ndër duar.

Sytë e të gjithëve u mbërthyen te duart e Behijes. Ajo e mbante litarin sikur të kishte mbërthyer qafën e një gjarpëri. Sofra e shtruar në mes të dhomës u harrua.

Behijes i erdhën si të papritura të gjitha këto. Sytë dhe mendimet e saj të shkëputura u pleksën te nyja e mallëkuar. Po të kishte biseduar Burbuqja më parë me të, po të kishte biseduar veçan me të, ndofta do të kishte pasur më shumë guxim, por, tani, ashtu papritur, si t'ja bënte?

Plaku trazonte zjarrin duke turfulluar. Hamdiu vështronte me inat mysafiret, herë gruan, herë motrën. Vetëm Besimi, që s'po ja ndante sytë Behijes, e shihte me dashuri e dukej sikur i thosh-te: «Jepi, motër, jepi, Behije!»

Behija nuk po vendoste dot. Donte ta flakte në zjarr atë nyjë, por tek vështronte të atin që turfullonte, tërhiqej. I vinte inat me veten e saj që nuk kishte guxim, atë guxim me të cilin shumë të reja të Shqipërisë po shqelmonin zakonet

e këqia, siç i kishin treguar vëllai i vogël dhe shoqet e fshatit.

— Digje, mos u lëkund! — Tingëlloi përsëri zëri i Burbuqes. — Sot e ka radhën litari, nesër veshja... — dhe mysafirja preku brekushet e malësore.

— Oj gocë, — foli papritur xha Mersini, me vetulla të ulura. — Ke ardhë mysafire dhe rri ashtu siç duhet!

— Mos u rrëmbe, xha Mersin, — ndërhyri Shpresa. — Ne biseduam edhe më parë rreth këtyre gjërave. Ti vetë the se ke dëgjar se ç'po bëhet në Shqipëri. Mos vallë prindët e tjerë nuk i duan fëmijët e tyre, nuk e duan nderin e shtëpisë, kur vendosin të heqin dorë nga zakonet e këqia? Apo pandeh ti se Partia, duke na porositur për këto gjëra, nuk mendon më për të mirën e popullit, për përparimin e vendit? Partia...

— Partinë mos e zë në gojë, — ja preu fjalën plaku. Ai deshi të thoshte diçka tjetër, por, si duket, nuk i gjente dot fjalët, sepse e la përgjysmë dhe filloi përsëri të trazonte zjarrin, të ngatërronte urët, të hidhte shkarpa të tjera. Zjarri mori flakë. Flakët nisën të ngrihen lart. E mbi flakët ra nyja e litarit. Një çast më vonë litari, i shtrirë në dhomë, qe ndarë më dysh. Burbuqja kishte përçafuar Behijen, nën Xhikja po shikonte nga sofa.

Atë natë, rrotull sofrës, u ulën të gjithë të hanë darkë.

TRAU I FUNDIT I SOLETËS

Betonimi kishte filluar qysh në orën shtatë të mëngjezit dhe gjithë ditën vazhdoi pa ndërprerje. Dielli u qëndronte punëtorëve si saç mbi kokë, aq sa nuk mund të dalloje nëse ishin lagur nga të djersiturit, apo ishin futur në lumë, ashtu, me gjithë rroba. Zhurma monotone e transportje-rit të shurdhonte veshët, po punëtorëve as që u bënte përshtypje kjo zhurmë. Ashtu të lodhur, ca nga vapa, ca nga puna e vështirë, ata e kishin përqëndruar vëmendjen vetëm te betoni, që e rrëmbenin lopatë mbas lopate dhe e vendosnin në shtresën e soletës.

Brigadieri Jaho Emiri ngjishte trarët e soletës me vibratorin cilindër. Ajo soletë kishte pesë trarë të mëdhenj me lartësi një metër e gjerësi dyzet centimetra, të vendosur secili mbi katër kolona betonarmeje dhe njëmbëdhjetë trarë të vegjël, që kryqëzoheshin me trarët e mëdhenj. Duhej kujdes i madh në betonimin e këtyre trarëve, sepse mbi ta do të mbështetej gjithë pesha e soletës.

Kur u plotësua tetëorëshi, brigadieri u tha punëtorëve se, ai që ishte lodhur e s'mund të qëndronte më, mund ta linte punën. Asnjëri nuk u

largua. Të gjithë, edhe pse ishin lodhur së tepërmi ishin gati të qëndronin gjer në fund. Deri në atë kohë (ishte ora tre e gjysmë) ishte betonuar pak më shumë se gjysma e soletës.

— Sa maqina me beton kanë ardhur deri tani? — e pyeti tekniku brigadierin.

— Dymbëdhjetë. Pra, sipas planifikimit, do të na vijnë edhe njëmbëdhjetë. Çdo dyzet minuta vjen një maqinë, po që se na vijnë pa ndërprerje, i japim fund para orës dymbëdhjetë.

— Ki parasysh se njerëzit sa vjen e lodhen më shumë, — vuri në dukje tekniku.

— Jemi mësuar edhe herë të tjera. Do të vazhdojmë me të njëjtin ritëm. Ti, në qoftë se ke ndonjë punë, ikë, se kujdesemi ne për cilësinë e betonit.

Teknikut i erdhën të rënda këto fjalë. Ju duk sikur brigadieri po i thosh: «Ti mos e hiq veten sikur të vjen keq për ne që jemi të lodhur; më mirë thuaje troç që përton të rrish vetë».

— E di unë që kujdesesh ti, se të kam parë dhe herë të tjera — tha duke varur vetullat, — po mos na shit mend; e di vetë nëse duhet të rri apo të iki — shtoi mbas pak.

Brigadieri nuk e merrte dot me mend pse i tha tekniku këto fjalë. Nga kjo ai e harroi vibratorin, i cili u fut si zvaranik nëpër hekurat e traut.

— Fike, fike, o Pilo! — i tha një punëtori që ndodhej pranë çelësit të vibratorit. Pila e ktheu dorezën poshtë dhe zhurma pushoi në çast. Ndërkaq tekniku që larguar. «Ç'njeri!» u inatos Jahua, «Të lë plumbin brenda dhe pastaj «fësht», ja bën, e ikën si hije». E ndezi vibratorin dhe vazhdoi

të punojë, por mendja i rrinte gjithmonë te fjalët e teknikut: «Të kam parë dhe herë të tjera». Vibratori futej thellë, e shpërndante betonin me vrull dhe Jahos i dukej se po me aq rrëmbim e qëllonin fjalët e teknikut: «mos na shit mend». E hoqi vibratorin nga ai vend dhe e vendosi në një vend tjetër, por mendimi vërtitej po aty, pa lëvizur. «E ka fjalën për betonimin e asaj kolonës që doli keq këtu e dy muaj më parë», i ra ndër mend. Jahua është nga ata që, kur u thua çfarëdo për veten e tyre, nuk nxehen fare, por po u the një gjysmë fjale të keqe për punën që bëjnë, nuk u del nga mendja për një kohë të gjatë. «E mbacka mend, s'e paska harruar. Po pse ma tha tani, nuk e kuptoj? Po ka edhe të drejtë. Për ne ajo është njollë dhe, gjersa ta shlyejmë, na duhet punë e madhe. Po me punë do ta shlyejmë». U mundua ta heqë mendimin prej saj, por ja që nuk i ndahej ajo koiona e betonuar dy muaj më parë.

Atij ju kujtua ajo ditë, kur për të ngjeshur betonin në kolonat dhe për t'i rrahur me sqepar armaturat nga jashtë, kishte caktuar Liman Rukën. Limani ishte treguar i vëmendshëm dhe i kujdesshëm, por aty nga fundi, si duket, i ishte mbaruar durimi dhe nuk e kishte ngjeshur betonin sa duhej. Kështu, kur bënë dizarmimin, kolonës që qe betonuar e fundit, i kishin mbetur nja dy hekura zbuluar. «Keq, keq!» — mendoi. «Po pësimi do të na bëhet mësim».

Aty rreth orës nëntë e gjysmë mbaroi betoni i maqinës së njëzetë. Deri atëhere, sa mbaronte njëra, vinte tjetra. Mirëpo asaj radhe maqina u vonua. Punëtorët u ulën të çlodhen. Ata që e pinin

duhanin ndezën nga një cigare. Ndejtën ashtu nja dhjetë minuta, pastaj, ngaqë ishin të djersitur, filluan të mërdhijnë, sepse edhe moti ishte freskuar.

— More po na vjen të ftohët. A lozim më mirë biz, — tha njëri prej tyre. Ishte Haliti, një djalë shakatar dhe i gëzuar.

— Këtij i zien gjaku, do që të ngjishet me pëllëmbë, — ja priti një tjetër.

— Rrini ore rehat, se jini të lodhur, ç'ju duhet juve të lozni. Kini edhe tri maqina akoma, — tha tekniku, që sapo kishte hipur lart.

— Po të rrimë shtrirë, kur të vijë betoni, duhet që të na vësh një motor me korent, pa të na lëvizin krahët, — foli përsëri Haliti. — Hajdeni ore, ngrihuni!

U ngritën dy vetë pastaj edhe një tjetër. Lojën e filluan ata të katër. Mbas pak në lojë hynë dhe të tjerë.

Teknikut i vinte çudi me këta njerëz, që s'mund të rrinin asnjë minutë të qetë, që e largonin lodhjen me gjallërinë e tyre të pashtershme. Bëri të largohej që aty, kur Haliti e zuri për krahu.

Teknikut i erdhi zor dhe po bënte naze. Më në fund, deshi s'deshi, e pranoi ftesën. I erdhi edhe atij radha të goditej nga të tjerët, por kjo nuk zgjati shumë, sepse erdhi maqina e betonit.

— Edhe më bëje naze — tha Haliti, — mos u mënjano kurrë, se ashtu nuk mësohesh dot! Thuaj shyqyr që erdhi maqina e betonit, se do të kishe mbetur mbrenda rrethit duke pritur pëllëmbët tona gjithë natën.

Halitit nuk i zemërohej asnjëri, sepse shakatë

i kishte pa të keq. Edhe tekniku nuk ju zemërua.

Tri maqinat e fundit erdhën njëra mbas tjetrës dhe një pjesë e betonit që mbeti përfundi e humbi aftësinë e duhur prandaj, për ta prurë përsëri në gjendjen e nevojshme, e përzien me një sasi çimentoje. Kjo punë ua shtoi më shumë lodhjen.

Kur mbeti, afërsisht, edhe një metër kub beton, brigadier i tha teknikut se trau i fundit i soletës nuk do të plotësohej i gjithë, prandaj duhej të pregatisnin vetë një sasi tjetër betoni.

— Prit, të mbarojmë këtë që kemi njëherë, pastaj shohim e bëjmë. Fundja e plotësojmë nesër atë pjesë të traut që do të mbetet.

— Po si u ndërpreka trau në këtë mënyrë, nuk ka rrezik që të shëmbet?

Teknikut i ra një hije e rëndë në fytyrë.

— Kush ka më shumë përgjegjësi për këtë, shoku brigadier, ti, apo unë?

Jahua nuk i lëshoi rrugë kësaj radhe.

— Nuk na hyn shumë në punë përgjegjësia. Shoku teknik. Unë mendoj që në radhë të parë është detyra. Pa detyrën e kemi të barabartë, si ti, si unë dhe të gjithë shokët e tjerë. Përveç rrezikut të shembjes, po të mos përfundohet betoni mi qysh sot, nesër bllokohet përsëri e gjithë brigada, sepse nuk do të mund të fillojmë armaturën e katit të dytë. Prandaj, do s'do ti, traun do ta betonojmë sonte, pa ndërprerje.

Ndërsa tekniku me brigadierin po vazhdonin të grindeshin, punëtorët po hidhnin lopatat e fundit të betonit. Trau ishte mbushur nja tridhjetë e pesë centimetra, duke kaluar nga kolona e tretë.

— Atëhere në regull — u tha tekniku punëtorëve, duke mos ua vënë veshin fjalëve të brigadierit. Largësia ndërmjet dy kolonave është dy metra, pjesa e tretë e traut është mbushur deri në sakomatë, pra në 1/6 e lartësisë midis kolonave. Teknikisht është krejt e lejuar që në këtë vend të ndërpritet betonimi. Ti, Jaho Emiri, derisa të jem unë këtu përgjegjës për punimet, do të zbatosh urdhërat e mia. Kur të bëhesh vetë teknik, vepro si të të duket më mirë.

Jahua po rrafshonte sipërfaqet e betonuara të traut me mallë druri. U ngrit që t'i pyesë shokët çfarë thoshin, por... malla i ra nga dora. Nga fjalët e teknikut ata ishin çarmatosur dhe njëri mbas tjetrit po zbrisnin nga soleta. Punëprishësi e shikonte sikur donte t'i thoshte: «E, kujt i shkoi fjala?»

— Nuk veprova mirë, shoku teknik. Kjo punë duhet të mbarohet sonte, dhe ne do ta mbarojmë patjetër.

I la veglat në vend dhe shkoi te shokët. Ata ishin në magazinë, po zhvishnin rrobat e punës dhe po bëheshin gati për të ikur. U shpjegoi shokëve ku qëndronte puna. Pastaj u kthye nga Haliti, që ndodhej pranë tij.

— E di ç'dua nga ti? — i tha duke i vënë dorën në sup, — ta bësh teknikun që të hyjë në vallen e punës, ashtu siç hyri në vallen e lodrës.

— Tani që mbaroi betoni u kujtove ti?

— Betonin, shokë, na duhet që ta pregatisim vetë e ta kryejmë edhe atë punë që na ka mbetur. Ejani, të mos e prishim të gjithë kazanin për një qepë!

Punëtorët u stepën për një çast.

Haliti vuri gishtin në tëmthin e majtë dhe, me një qëndrim prej oratori shakatar, ju drejtua shokëve:

— Dëgjoni këtu, shokë! Përpara na del një detyrë e rëndësishme! — Pastaj u foli seriozisht. — Të mos e marrim me shaka...

— Ti vetë po e merr me shaka, — ja priti njëri nga shokët.

— ... Ashtu është — e mori fjalën Haliti. — Unë e mora me shaka, por tani po flas seriozisht. Brigadieri ka të drejtë, prandaj, o burrani, t'i përvishemi punës!

Ai u nis i pari dhe mbas tij me radhë gjithë të tjerët.

Ndërsa ata punonin me gjithë shpirt, tekniku rrinte dhe i shikonte i inatosur. «Po pse vepron kështu?» mendonte me vete Jahua. «Ç'humbet ai në rast se punën e nesërme ne e mbarojmë që sot? Apo egoizmi, që ne po ja shkatërrojmë me punën tonë, e bën që të mos e ndjejë veten mirë?»

Tre çerekë metro kub beton që duhej e pregatitën brenda pesëmbëdhjetë minutave dhe mbas kësaj filloi të transportohej. U duk sikur puna shkonte mbarë, por nuk zgjati shumë dhe doli rripi i transportjerit.

— O burrani ta ndreqim! — u dëgjua zëri i Jahos, ndërsa tekniku buzëqeshi me ironi.

Të gjithë punëtorët filluan të tërheqin rrypin për ta vënë në vend.

— Po ky, ç'më rri si hu, ndërsa neve po na del shpirti duke tërhequr gjithë këtë derr rripi — foli Haliti nëpër dhëmbë i nxehur. — Hë, pa ja

tregoj unë tani! — Dhe me qëllim e tërhiqte rripin nga ana e kundërt.

— Jo andej, o Halit, se i more në qafë shokët që po e tërheqin në drejtim të kundërt.

— Pa rri rehat aty ti dhe mos na çaj kokën! Po t'u dhimsën shokët, hajde e i ndihmo dhe mos më rri aty si djalë beu. Unë kështu di, kështu punoj. Po dite më mirë ti, hajde më mëso.

Teknikut ju duk sikur i mori koka flakë.

— Ja kështu shtyhet — i tha Halitit me inat dhe filloi edhe ai të tërheqë rripin me forcë.

Rripi i transportjerit i mundi shumë. Kur mbaroi betonimi plotësisht, ora kishte kaluar nga tre.

— E, brigadier! A e futa teknikun në punë, apo jo? — Ju krekos Haliti Jahos.

— Po, të lumtë, ju lumtë, o shokë! Tani punën për nesër e kemi në rregull.

Në mëngjez, kur erdhën brigadat e tjera, të gjithë e shikonin punën e brigadës së Jaho Emirit. Me admirim vërente edhe tekniku, që e njohu për herë të parë forcën e madhe të këtyre punëtorëve në betonimin e traut të fundit të soletës.

SHATËRVANI I PRISHUR

Vështrimi i syve të Ditarit u ngul në fytyrën e inxhinierit, që po shfletonte projektet e vendosura mbi tryezë.

— Shoku inxhinier, erdha për të biseduar diçka me ju — foli Ditari, duke qëndruar përballë tij, ndërsa duart i lëvizte, sikur nuk kishte ku t'i mbante.

— Bisedim i gjatë apo i shkurtër? — Inxhinieri vazhdonte të mos i hiqte sytë nga vizatimet.

— Kjo varet edhe nga ju.

— Për mua ka mbaruar që tani, sepse jam shumë i zënë me punët e mia...

— Megjithatë do të flasim edhe për një punë tjetër — ja rrëmbeu fjalën Ditari. — Kjo nuk është vetëm puna ime, por është dhe juaja, e të gjithëve...

Inxhinieri vuri gishtin atje ku ndërpreu leximin. Fytyra bullafiqe u tendos mbi qafën e shëndoshë. Sytë e tij tregonin mërzi për këtë ndërhyrje.

— Bjeri shkurt! Mos na bëj moral! — E ndërpreu inxhinieri.

— Shkurt? Mirë. Pse i keni lejuar suvatorët

e brigadës sonë të përdorin në skelë dërrasa treshe, të cilat na duhen për t'i përdorur në armaturë?

— U kam dhënë urdhër teknikut e brigadierit. Me ata shko merru vesh!

— U thashë që të dyve. Tekniku i çirret brigadierit që t'i heqë dërrasat treshe nga skelat, kurse tjetri i kërkon dërrasa pesëshe. Dhe si përfundim dërrasat mbetën po aty ku ishin. Prandaj unë erdha të bisedoj me ju që jeni shefi i sektorit.

— Një herë tjetër e shikojmë këtë punë. Tani nuk kam kohë — tha inxhinieri, duke i ngulur sytë te fletët e projektit.

Ditari ja palosi letrat më dysh.

— Mos u mundo të më përcjellësh me ujë në shoshë. Merr masa që të na vijnë dërrasat për skelë dhe kjo punë të rregullohet.

U duk sikur sytë e inxhinierit dolën nga vendi. Karriga, që mbeti e lirë nga pesha e rëndë e trupit të tij, kërceu pak përpjetë, sikur të donte ta falënderonte Ditarin për të mirën që i bëri.

— Të marr masa që të vijnë dërrasa për skelë! — Hunda e inxhinierit qëndronte dhjetë-dymbëdhjetë centimetra nga hunda e Ditarit. — Pse, furnitor jam unë?

— Për interesin e punës, mos u kurse! Edhe furnitor të bëhesh, posi! — Këto fjalë Ditari i tha me rrëmbim, sikur të ngulte një gozhdë tetëmbëdhjetëshe në një binar prej ahu. Pastaj, pa e hequr vështrimin nga inxhinieri, vazhdoi më shtruar. — Ja, për këtë erdha këtu, që të të shqetësoj, që të mos rrish gjithë kohën mbi këto shkresa dhe e shoh se ja arrita qëllimit.

— Ja arrite, ja arrite, po ki mendjen mos e tepro, se të rrëmbej për xhakete e të flak përjashta.

— Dhe kujton se me këtë kërcënim do të më trembësh? Më shtruar, më shtruar, shoku inxhinier. Nuk t'i them me zemërim, por me keqardhje këto fjalë. Harron se edhe unë kam pjesë po aq sa ti në këtë zyrë.

Tani ata shikoheshin sy ndër sy. Inxhinier Parimi e ndjente se nuk kishte më fuqi për t'u mbrojtur prej këtij sulmi të befasishëm. Ai e kishte përdorur kërcënimin si fishek të fundit, për ta prapsur kundërshtarin. Por ç'e do, i shkoi kot. Nga ana tjetër edhe Ditari i mbaroi ato që kishte për të thënë. Para se të hynte në zyrë, ai nuk e merrte me mend se puna do të arrinte deri këtu, por megjithatë nuk u pendua. Fundi i fundit atij nuk i vinte mirë që inxhinieri, shefi sektorit të ndërtimit, të mbyllej gjithë ditën në zyrë dhe të rrinte krejt i veçuar nga kolektivi.

— Kaq kisha unë, — tha Ditari dhe u nis për të dalë por, si bëri disa hapa në drejtim të derës, u kthye dhe i tha: — Ne presim dërrasat për skelën.

Ai iku dhe zjarri që ndezi u shua, por tymi mbeti brenda në zyrë. Inxhinier Parimi mbeti me sytë të mbërthyer te dera. I pafuqishëm, u ul në karrige, por sytë nuk i hiqte nga dera, sikur të shikonte një vazhdë rruge që nuk e kishte vënë re ndonjëherë. I dukej sikur kjo zyrë nuk ishte më për të, sikur nuk e nxinte më brenda. «S'ka kuptim, derisa vjen tjetri, të bërtet e të jep urdhëra në zyrë sikur të jetë në shtëpinë e tij, s'ka

më vend për mua këtu. Çfarë arroganti! Njeri pa kurrfarë edukate! Nuk di as rregullat më elementare të respektit dhe të mirësjelljes» — shfrynte me vete inxhinieri. Mbas pak u përpoq me të gjitha forcat që ta hiqte mendjen nga kjo çështje. Ishte e pamundur. Fytyra e Ditarit i dilte përpara si një mur, që u ngrit ashtu papritur në mendimet e tij, një mur që ai nuk mund ta kapërcente. Projektet kishin mbetur të palosura më dysh mbi tryezë dhe në to dukeshin shenja pluhuri nga gishtërinjtë e Ditarit. E mblodhi dorën grusht, e shtrëngoi fort dhe desh ta përplaste te vendi ku dukeshin njollat e gishtërinjve. Po mendoi se do të thyhej xhami, se do të vriste dorën dhe e lëshoi përsëri atë sipër gjurit. Nga nervozizmi nuk mund të qëndronte në karrige. U ngrit dhe filloi të ecte nëpër dhomë me hapa të mëdhenj, si i çakërdisur.

Që nga jashtë hyri nëpër dritaret dhe u përplas në veshët e tij një zë i fortë:

— Hooooop! Forca, çuna!

Inxhinieri e ndaloi hapin në çast. Ishte zëri i Ditarit ai, që ngrihej si oshëtimë mbi ndërtesat e sektorit. «Ka ardhur transportjери dhe e çojnë në vendin e punës për të betonuar rezervuarin», i shkoi nëpër mend. I erdhi inat që zëri i Ditarit ja tërhoqi përsëri vëmendjen. «Dreq! Sikur s'ka njeri tjetër që të komandojë shokët për të shtyrë transportjerin...» Mbeti pa lëvizur disa çaste, pastaj vajti në tryezë, i mblodhi projektet, i futi në sirtar dhe doli përjashta.

Kur arriti te rezervuari, transportjери donte dhe tre-katër metra që të vendosej në vendin e

dudur. Atje ishte një pjerrësi. Shokut që ishte pranë Ditarit i rrëshqitën këmbët. Ditarit i ra gjithë pesha në sup. Hekuri po ja shtypte kockën, por ai nuk jepej, megjithëse gjunjët i dridheshin nga sforcimi i tepërt. Inxhinier Parimit ju duk sikur qindra gjilpëra ja shpuan trupin. Nuk mendoj më gjatë, po u sul me vrap dhe vuri supin te vendi ku ishte punëtori, që i rrëshqitën këmbët dhe që ende nuk ishte ngritur. Ditari mori frymë lirisht, ngaqë ju lehtësua pesha. Më në fund transportjeri u vendos në vend. Parimi dhe Ditari shikuan njëri-tjetrin. «Mbetë ngushtë» sikur thoshin sytë e të parit. «Të faleminderit», përgjigjej vështrimi i tjetrit. Inxhinieri u kthye dhe vajti te brigadieri. Ndërkaq edhe punëtorët u shpërndanë secili në vendin e vet. Të nesërmen do të fillonte betonimi i rezervuarit.

* * *

Atë natë inxhinier Parimi vërtitej në krevat si peshku në zall. I dukej sikur Ditari i qëndronte gjithmonë pranë, mu përpara fytyrës. Që nga koha e grindjes, mendimet i silleshin po në një pikë, si kali që rrotullohet në lëmë rreth strumbullarit.

Dalëngadalë mendimet po i kthjelloheshin dhe po merrnin një formë më të saktë. Ishte hera e parë në jetë, që inxhinier Parimit i ndodhte një gjë e tillë, një grindje me një vartës të tij. Megjithëse në dukje ishte një grindje e parëndësishme, atij i bëri përshtypje të thellë. Ai ishte mësuar t'i dëgjonte dhe t'u zbatonte urdhërat she-

fave, por vartësve kurrë! Vartësit ishte mësuar vetëm t'i urdhëronte. Po t'ja thoshte drejtori apo kryeinxhinieri ato që i tha Ditari, atëhere ndryshonte puna. Mendimi i vërtitej nga të gjitha anët dhe logjika e tij i bënte një pyetje të thjeshtë: Pavarësisht se kush e tha, por a është e drejtë ajo që tha? Nga kjo pyetje e ndjente veten të zënë ngushtë dhe mendonte e rimendonte përsëri e kërkonte justifikime për të përligjur qëndrimin e tij.

Kaloi kështu shumë kohë duke menduar dhe gjumi nuk e zinte më. U çua dhe qëndroi ndenjtur në buzë të krevatit. E ndjente trupin të këputur, sa kurrë ndonjëherë. Padashur, vështrimi i ndeshi tek pasqyra e garderobës, që e kishte përballë. U tmerua nga pamja që i doli përpara syve. Që nga pasqyra e shikonte një burrë bullafiq me sy të enjtur e të skuqur. Nuk i erdhi mirë që bëri këtë konstatim te vetëvetja dhe, i dëshpëruar, i hoqi sytë andej. Në mes të murit, më të djathtë të pasqyrës, ishte vendosur një fotografi e mbyllur në kornizë. Ishte një kujtim nga jeta e rinisë — kujtim i gjallë i atyre viteve plot vrull e entuziazëm. Nga gjithë ajo jetë dinamike, Parimit vetëm kjo i kishte mbetur. Atje kishte dalë së bashku me shokët, i kujtohej mirë, atëhere kur kishin shkuar vullnetarë në Rrugën e Dritës.

Ashtu siç ishte me të mbathura e në kanatje-re, u afrua pranë fotografisë dhe nisi të kundrojë me imtësi, një nga një, të gjitha fytyrat. Në mes të shokëve, buzëgaz e fytyrëçelur, me vështrimin hedhur tej në horizont, qëndronte ai, Parimi njëzetvjeçar. Parimi i aksioneve, me syrin pishë, gati për t'u vërsulur drejt shtigjeve të reja.

Përreth tij qëndronin shokët, dhe ata energjikë e syzjarrtë, entuziastë. Ndërsa përfund tyre, me këmbë të zbathura, ngjitur pas dyshemesë, qëndron-te inxhinier Parimi, tanimë i dhënë shumë pas rehatisë dhe i veçuar prej shokëve.

«Po ku janë shokët tani?» — Belbëzoi nëpër dhëmbë dhe u përpoq t'i sjellë ndër mend ata, u përpoq të rikujtojë kur i kishte takuar për herë të fundit, ku punonin... Ata ishin kudo, ishin përhapur në të gjitha anët e vendit, nëpër fabrika, nëpër kantiere, disa nëpër zyra... Por, tani i ndjente përsëri pranë dhe, çudi, i dukej sikur të gjithë e vështronin nga fotografia. Dhe si e vështronin! Sa domethënje kishin ato vështrime. Ata sy të zjarrtë ishin hetues, qortues, ndës'lkues...

Nuk mundi t'i përballonte më gjatë ato vështrime. I lodhur nga pagjumësia dhe nga ky acarim nervor, me një trishtim të thellë të brendshëm, u shtri në krevat dhe bëri një gjumë të trazuar, me hope, sikur të kishte fjetur midis një grumbulli hithrash.

* * *

Ndodh nganjëherë që, kur na zë shiu në rru-gë, nuk qortojmë veten pse s'kemi marrë çadrën, për mallëkojmë kohën e keqe, si kur të na e ketë bërë për inat. Dhe, kur fillojnë të bien pikat e para të shiut, vemi me shpresë se nga çasti në çast do të pushojë dhe largojmë mendimin se mund të shpërthejë furtuna, sepse i trembemi asaj. Përafërsisht një ndjenjë të tillë provonte në vetëvetë edhe inxhinier Parimi. Shqetësimi nga grindja që

pati ai me Ditarin do të kishte kaluar si shkumë sapuni mbi gunë, sikur të mos ishte parandjenja e një kontrolli më të rreptë dhe të gjithanshëm nga ana e punëtorëve. I trembej prishjes së rehatit. Dhe për këtë, në radhë të parë kishte inat Ditarin, sepse ai e ngacmoi për herë të parë.

Tri ditë pas grindjes së inxhinier Parimit me Ditarin u bë mbledhja e zgjeruar e organizatës bazë të partisë të kantierit, me rend dite: «Mbi pjesëmarrjen e kuadrove drejtpërdrejt në punën prodhuese.

Mbledhja fillonte në orën pesë të mbrëmjes, në sallën e klubit të kantierit. Parimi vajti pesë minuta përpara e zuri vend në një stol pranë dritares. Në dy stola, në krye të sallës, ishin ulur disa vetë dhe bisedonin me zë të lartë. Parimi ngriti vështrimin dhe vuri re parullat e citatet e vendosura mureve përreth. Përballë tij qëndronte një tablo ku qe vizatuar një banesë në ndërtime e sipër. Në skelë një inxhinier dhe një murator konsultoheshin së bashku. Në sfondin e tablosë shtrihej një panoramë e bukur: një fushë me grurë, kallinj të së cilës ngjanin si dallgë deti dhe më tej, në mbarim të grurit, ngrihej një kodrinë e zbukuruar me vreshta. Parimi vështronte si i hutuar dhe as që mund ta përcaktonte se çfarë ndjenje i ngjallte kjo tablo.

Njëri mbas tjetrit erdhën të gjithë pjesëmarrësit dhe, tamam në orën pesë, sekretari i organizatës bazë të partisë hapi mbledhjen.

Parimi e njihte Jorgaqin, sekretarin e partisë së kantierit. E dinte që ishte murator shumë i mirë, punëtor i palodhur, racionalizator. Parimi vë-

rente se, ai burrë me jakën sipër xhaketës dhe fytyrën me rrudha, që nga pamja s'ta mbushte syrin, ishte mjaft i pjekur dhe i pregatitur. Fliste thjeshtë e qartë, me fraza të shkurtëra, si i thonë fjalës, e ngulte gozhdën me dy të rëna të sqeparit. Parimi e dëgjonte me vëmendje këtë referat dhe, aty për aty, i ribluante në trurin e tij mendimet që shpreheshin. «Në qoftë se duam të kemi kuadro të shëndoshë, duhet të kërkojmë sa më shumë punë prej tyre. Nuk mund të jesh drejtues i mirë, pa qenë edhe një punonjës i mirë. Një inxhinier vetëm me përsosuri nga ana profesionale, është një zanatçi i mirë, por jo një kuadër me vlerë. Një drejtues i mirë është vetëm ai punonjës i kuadrit, që punon e jeton, që shkrihet me punëtorët. Të tillë kuadro duam ne. Këto janë kërkesat e kohës.» Më tej Jorgaqi paraqiti fakte konkrete nga puna e kuadrove në kantier, vuri në dukje të mirat, por bërthamën e referatit e përbënte kritika.

Kritika e fortë e referatit shkaktoi shpërthimin e diskutimeve të zjarra.

Parimi e ndjente shumë peshën e kësaj mbledhjeje. Në trurin e tij vazhdonte zhvillimi i dramës, perden e së cilës e kishte hapur Ditari në zyrën e sektorit. Atje, ulur në stolin afër dritares, duke dëgjuar ata që flisnin, ai po i bënte një analizë vetëvetes.

... Diplomën e inxhinierit e kishte marrë trembëdhjetë vjet më parë. Atëhere endërronte që të punonte nëpër kantiere të ndryshme, të linte kudo djersën dhe gjurmët e punës së tij. Por këtë ëndërr e mbajti të mbyllur brenda vetes dhe nuk

mundi ta vejë në jetë, pasi mbaroi shkollën në zyrën e planit, në ndërmarrjen e ndërtimit. Këtu u dha pas shkresave. Kjo ishte puna e tij. Dhe rrjetin e shoqërisë së tij njerëzit e shkresave e formonin. Edhe shija, pikëpamjet e tij rreth jetesës morën një trajtë tjetër. Mbrëmjet i kalonte me njerëz «të zgjedhur». Në shtëpi kishte vetëm të ëmën. Nëna i lutej gjithmonë që të martohej, t'i sillte një nuse në shtëpi, sepse, meqë qe plakë, nuk i bënte dot gjithë punët e shtëpisë. I biri çuditej nga këto lutje «manjake» të së ëmës. Ai as merrte mundimin që të mendonte për martesë. Por me punët e zyrës u miqësua siç duhej. Nuk i erdhi mirë që e transferuan nga zyra e planit dhe e emëruan shef sektori. Atëhere nxori edhe një sërë justifikimesh, se gjoja nuk e kryente dot detyrën e inxhinierit të zbatimit, sepse i mungonte përvoja e plot të tjera. Përgjegjja ishte e prerë: Përvoja fitohet në punë. Por edhe në punën e re vazhdonte po me metodën e mëparshme...

Dikush nga diskutantët përmendi emrin e tij. Ktheu kokën anej nga vinte zëri. Ishte Ditari ai që po fliste. Njërën dorë e mbështeste në shpinën e stolit që kishte përpara dhe tjetrën e lëvizte, duke shoqëruar fjalët, si për të theksuar mendimet.

«Unë u rrëmbeva» vazhdoi Ditari diskutimin, «dhe e pranoj që u solla cazë arrogant para shefit tim të sektorit, në zyrën e tij. Për këtë shokët e brigadës më kritikuan. Po unë veprova kështu për të mirën e punës. Ne, të gjithë, punëtorë, teknikë, inxhinierë, punojmë për të njëjtin qëllim dhe këtë qëllim të përbashkët do të mund ta realizojmë,

jo kur njëri t'i bjerë trokës dhe tjetri këmborës, po kur të punojmë sa më shumë, të përkrahim njëri-tjetrin në punë, të lidhemi më ngushtë me problemet e punës. Unë për këtë i heq vërejtjen inxhinier Parimit, sepse ai qëndron larg punës, larg nga punëtorët, nuk jeton me problemet e përditshme të sektorit tonë. Inxhinier Parimi të shumtën e kohës e kalon i mbyllur në zyrën e tij, thua se ato shkresa janë gjërat më të rëndësishme...»

Diskutimet mbaruan. U aprovua plani i masave dhe u caktua koha e vendi i punës fizike që do të kryente secili nga punonjësit e kuadrit. Inxhinier Parimi do të punonte gjashtë ditë në muaj në brigadën ku punonte, bënte pjesë dhe Ditari.

* * *

Flluskën e parë në dorë inxhinier Parimi e quajti si diçka të jashtëzakonshme. I dhimbte shumë, dhe nuk e afronte kurrë bishtin e çekiçit apo të mistrisë pranë saj. E përdorte veglën me vësh-tirësi dhe si pasojë, u krijua shumë shpejt flluska tjetër. E dyta u pasua nga e treta dhe kështu me radhë. Ndërkohë, flluska e parë u shërua, me këtë edhe inxhinier Parimit i doli frika nga këto flluska, me të cilat puna lë gjurmë në duart e njeriut. Në të njëjtën kohë filloi të miqësohej edhe me punëtorët.

E shihte se qetësisë së dikurshme po i thosh-te lamtumirë. Kur kalonte nëpër objekt dhe vërente copa tullash, ose lëndë druri të pasistemuar, i merrte dhe i vendoste në vendin e tyre...

...Edhe në kohën e lirë nuk mund të rrinte pa u marrë me ndonjë punë. E ëma nuk e merrte dot me mend këtë ndryshim të të birit. Plaka e shkretë arësyetonte me të veten: «I ka rënë ndër mend që të martohet, prandaj s'i rrinë duart pa punë...»

Shtëpia e Parimit përpara kishte kopshtin e fëmijëve. Në mes të oborrit ndodhej një shatërvan. Të gjitha këto i pat ndërtuar i ati i Parimit, që ishte murator.

Tani, mbas kaq vjetësh, Parimi po rikujtonte mundin dhe djersën që pat derdhur i ati në atë punë. Shatërvani kishte zënë ndryshk. Ndryshku kishte bllokuar tubin që hidhte ujin përpjetë. Të vinte keq kur e shikoje ashtu në atë gjendje.

Një pasdite, kur po kthehej nga puna, i bëri përshtypje shatërvani i prishur në mes të oborrit. Solli ndër mend se sa shumë i përllqente ky shatërvan atëhere, kur ishte i vogël. Ujët hidhej pesë-gjashtë metra përpjetë, pastaj shpërndahej dhe binte poshtë në formë pikash, të cilat, nën shkëlqimin e rrezeve të diellit, merrnin ngjyrat më të ndryshme dhe më të bukura.

Vendosi që ta regullonte. U afrua pranë shatërvanit dhe qëndroi me duart të mbërthyera kryq. Shatërvani dukej si një i sëmurë i paralizuar, mbërthyer në shtrat. Ai shatërvan kishte vuajtur nga një sëmundje e gjatë, e cila dalëngadalë e nxori jashtë përdorimit.

Prandaj, ai, inxhinier Parimi, rrinte ashtu me duar të kryqëzuara. Donte të rregullonte shatërvanin. Duheshin pastruar tubat e ndyshkur.

Ju vu punës që të zhvidhoste kokën e tubit,

nga ku ujët duhej të hidhej me presion përpjetë. Puna ishte e vështirë. Vidat ishin ndryshkur. Çelës mekanik nuk kishte. Mori një gur dhe i ra me të. Asgjë. Provoi disa herë me radhë, duke i mëshuar me forcë. Guri u dërmua në copa të vogla, ndërsa koka e tubit qëndronte pa u tundur nga vendi.

Qëndroi më këmbë, me duar të lëshuara. Vështroi rrotull, sikur të kërkonte ndihmë. Nga një ballkon i katit të tretë të pallatit, që ngrihej anësh kopshtit, e shikonte një vajzë e veshur me pantallona dhe xhakëtë blu. Mënyra e të vështruarit të saj se si ju duk Parimit dhe i hoqi sytë nga ajo krejt indiferent, sikur s'kishte të bënte fare me të. Por, pas pak, i drejtoi përsëri sytë te ballkoni. Ajo vazhdonte ta vështronte po në atë mënyrë. Kësaj here vështrimi u shoqërua me një buzëqeshje. Edhe kjo buzëqeshje se si ju duk Parimit dhe u mat përsëri që ta hiqte vështrimin andej, por ndaloi, kur dëgjoi që vajza i foli:

— E, inxhinier e paske filluar për së mbari?

Edhe zëri që dëgjoi se si ju duk Parimit. Edhe atyre fjalëve nuk gjeti se çfarë përgjegje t'u jepete, prandaj u pendua që e shikoi dhe e dëgjoi...

Ajo nuk e la që të merrej gjatë me këto mendime, i foli përsëri:

— Të paska rënë ndër mend që të rregullosh shatërvanin?

Kjo vajzë kishte nja gjashtë muaj që banonte në këtë lagje. Gjatë kësaj kohe Parimi e kishte parë shpeshherë. Nga e ëma kishte dëgjuar se ishte hidraulike. Ndërsa ai qëndronte i mënjanuar nga të gjithë, si i huaj në lagjen e tij, ajo u njoh

shumë shpejt dhe u miqësua me komshinjtë, hynte e dilte ndër ta sikur të njihej prej vitesh. Edhe me nënën e tij, teto Feruzen, kishte zënë mjaft miqësi. Teto Feruzes i pëlqente shumë kjo vajzë, prandaj dhe e donte pa masë.

Ajo vazhdonte të vështronte dhe të buzëqesh-te. Edhe Parimi vështronte pa ditur ç'të bënte: Të buzëqesh-te edhe ai, apo jo? Pastaj i hoqi sytë andej. S'kishte kuptim. Çdo të thoshte një vësh-trim i tillë? Shikomë, të të shikoj. Mori një gur tjetër dhe zuri t'i bjerë prapë kokës së tubit me të.

— A të vij të të ndihmoj unë? — foli vajza.

Parimi ngriti kokën. Sytë e tij atë çast tregonin njëfarë bezdie të përzier me çudi dhe mos-besim.

Vajza u largua nga ballkoni. Mbas pak u duk te porta me nja dy tuba dhe disa vegla hidraulike në duar.

Parimi e priti në heshtje. Ai nuk po merrte vesh se ç'po bëhej dhe vetëm rrinte në këmbë, heshte.

Ajo e mbërtheu kokën e tubit me çelësin hidraulik dhe e vërtiti me forcë. Vidat nuk binde-shin.

— Më ndihmo, ta rrotullojmë bashkë, inxhi-nier!

E rrotulluan çelësin mbas tubit të dy së bashku. Vidat filluan të lëvizin, thuhetse më pak se një milimetër. E vërtitën disa herë çelësin dhe vidat filluan të lirohen. Parimi u çudit me veten: kish-te djersitur dhe s'e kishte vënë re fare.

— Më në fund e hoqëm — tha vajza. Kokën

e tubit e mbante në dorë dhe vërente tubin që ngrihej përpjetë. Ky tub ishte vulosur krejt nga ndryshku. — Duhet hequr edhe ky, inxhinier, se këtu në vend nuk pastrohet.

E hoqën dhe morën rrugën për në shtëpi.

Manushaqja buzëqeshte. Parimi vërente Manushaqen.

* * *

— More, si shumë e kanë regulluar këta të dy, — i thoshte një suvator shokut që kishte pranë, duke bërë me kokë në drejtim të Ditarit e inxhinier Parimit, të cilët po vendosnin një dritare nja pesëmbëdhjetë-njëzet metra më tej.

Suvatori tjetër vështroi andej nga i tregoi shoku. Ditari po mbërthente dritaren me gozhdë dhe fliste me buzë në gaz. Inxhinieri e dëgjonte me vëmendje, pastaj ja dha së qeshurës me zë të lartë.

— Epo kështu është — ju kthye suvatori i dytë të parit. — Nuk i thonë kot: po s'u turbullua, nuk kullohet. Është djalë i mirë ky Ditari. Është edhe i zoti dhe e kam qejf, se është i drejtë. Ama, po të pa që ja bën viu andej e viu këtej, ta këputi dhe pastaj dije se e ke pisk me të.

— Mor po edhe inxhinieri si shumë ka ndryshuar. Në fillim e nisi cazë si përtuar, por tani po e heq vallen për merak. Kapedan fare është bërë.

— Duket, duket, i qesh nuri. Seç do të ketë ndonjë gëzim në zemër. Disa muaj më parë ngjante si natë kollozhegu, tani si mëngjez maji.

— Më duket se e ka rregulluar me atë hidrauliken. Ja, besoj se për atë po bisedon edhe

me Ditarin, se e shoh që nuk e frenon dot gëzimin që ndjen përbrenda.

— Cilën hidraulike?

— Të kujtohet ajo brigadierja, kur punonim në radiodifuzion?

— Manushaqja?!

— Po. Ama goxha vajzë është, apo jo?

— S'ke ç'i thua. Po sikur nuk para shkojnë si çift. Pastaj inxhinieri është cazë më i madh në moshë.

— E, mirë, o mirë. Unë i pashë një mbrëmje në xhiro. Inxhinieri dukej sikur fluturonte, shend e verë ishte bërë. Është nja dhjetë vjet më i madh, po, a nuk ke vënë re ti, se që filloi t'i firaset barku, ngjan si djalë njëzet e pesë vjeç?

Ndërkaq ra çanga për pushimin e drekës. Ata lanë veglat në vend dhe zbritën nga skela.

Dhoma ku hanin bukë punëtorët ishte rregulluar me tryeza dhe stola prej dërrase. Atë drekë, së bashku me punëtorët e brigadës ku punonte Ditari, u ul për të ngrënë bukë dhe inxhinier Parimi.

— Tani do të ngrihet mensa në objekt patjetër — tha njëri nga punëtorët. — Disa herë e kemi kërkuar, por s'na është vënë veshi. Tani që edhe shefi i objektit u ul në një stol me ne, ka mbaruar kjo punë.

Parimi e kishte në të djathtë këtë punëtor. E vërejti me vëmendje, po jo me inat. «S'ta përtojnë këta» tha me vete. «Ta përplasim kritikën në fytyrë dhe të thonë»: «E mbajtsh me shëndet».

— Epo të gjitha nuk rregullohen menjëherë.
— U hodh Ditari.

Filluan të hanin bukë. Ndonjëri këpuste ndonjë shaka dhe të tjerët qeshnin, duke vënë dorën përpara gojës.

Mbasi hëngrën bukë, ndezën dhe nga një cigare. Ditari ju drejtua inxhinierit me buzë në gaz:

— Hë, inxhinier, kishe ndonjë gjë për të na thënë?

Edhe Parimi qeshi:

— Unë ta kam lënë ty në dorë — tha ai:

— E dini si është puna? — Filloi Ditari dhe, ndërsa fliste, vazhdonte të buzëqeshte e i vështronte shokët të gjithë me radhë. — Sot është e martë. Të dielën inxhinier Parimi martohet dhe na fton në dasmë të gjithë ne, punonjësit e brigadës. Do që t'i ndodhemi në këtë gëzim. Si thoni ju?

— Pa tjetër! Të na trashëgohet dhe me jetë të lumtur! — u dëgjuan disa zëra përnjëherësh.

— Ju faleminderit! — i tha inxhinieri. Atij i qeshte zemra.

* * *

Parimi nuk ja hiqte sytë pasqyrës. Vendoste të largohet andej. Bënte disa hapa dhe prapë kthehej e vështronte veten. Barku i tepërt, që dikur ngjante si një mur i vjetër qerpiçi gati më të rrëzuar, nuk ekzistonte më. Fytyra e porsarruar i shkëlqente. Sytë i ndritnin. Trupin e ndjente shumë të lehtë. Tani shëmbëllente shumë me atë Parimin e parë. I hodhi një vështrim përsëri fotografisë. Dhe shokët tani sikur e shikonin nga fotografia dhe i buzëqeshnin.

Nga dritarja e hapur fryu një erë e ngrohtë

dhe ja ledhatoi fytyrën. Ishte një mbasdite shtatori, në të perënduar. Hodhi sytë nga dritarja dhe u kënaq kur pa ujët e shatërvanit që shkëlqente me dhjetëra lloj ngjyrash nën ndriçimin e rrezeve të diellit.

Te dera u duk Manushaqja me teto Feruzen.

— Parim, a u bëre gati?

— Ja, erdha!

Ta shihnit sa i qeshur ishte atë mbrëmje Parimi, me siguri do të gëzoheshit edhe ju.

45 MINUTA MBI ÇATI

Ora dy e pesëdhjetë minuta. Një burrë me pamje krejt të zakonshme dhe me veshje po të zakonshme hyri në ndërtesën ku ndodhej furra e shkrirjes. Kur u ndesh me afshin e nxehtë, ashtu padashur e ktheu edhe një herë kokën dhe shikoi jashtë retë e dendura e të ngjeshura fort pranë njëra-tjetrës. Era e fortë nuk i linte të qeta për asnjë çast grumbujt e reve. Uli jakën e xhakëtës dhe u drejtua për në vendin e teshave. Që andej doli i veshur me kominoshe dhe në mënyrë krejt të natyrshme eci drejt derës së furrës.

Atë ditë dhjetori, kur retë qenë dendësuar së tepërmi dhe era frynte si e marrë, ai qe turni i dytë dhe fillonte punën në ora tre.

Por atë mbrëmje dhjetori me shkrirësin Qemal Lica dhe me shokët e tij ndodhi diçka që pri-shi ecurinë e punës së tyre.

Puna vazhdonte me ritmin e zakonshëm. Nata e kishte mbështjellë gjithë ndërtesën në gjirin e saj. Retë e dendura e të ngjeshura fort pranë njëra-tjetrës e shtonin edhe më shumë errësinë. Nga ato re të ngjeshura lëshohej shiu si i tërbuar. Era i rrëmbente rrëketë e shiut dhe i përplaste

ku të mundte. Dukej sikur tufani e sulmonte ndërtesën pa ndërprerje.

Punëtorët e përqëndronin vëmendjen vetëm tek puna e tyre.

— Si vete? — pyeti përgjegjësi i turnit, Idrizi.

— Shumë në rregull — u përgjegj Qemali, ndërsa vështrimin e mbante tek ajo masë e madhe e zjarrtë, që shkrinte brenda në furrë. Temperatura kishte arritur 1500 gradë Celsius.

Disa pika shiu u lëshuan mbi qemerin e furrës, por nxehtësia i thau ato përnjëherësh. U vërsulën pika të tjera shiu, më të shumta; pastaj rrodhën çurka të pandërprera. Era si duket kishte shkallmuar llamarinat e çatisë të baxhos...

Qemal Sera i mbërtheu sytë mbi qemerin e furrës, pikërisht në vendin ku binte shiu. Shkri-rësit i rrahu fort zemra: munda e djersa e shokëve do të shkonin kot, 80 ton brumë në furrë nuk do të ktheheshin në qelq për shkak të atij shiu që lagte qemerin. Qemeri i furrës mbi të cilin vazhdonin të derdheshin currilat e ujit dhe që avullonte përherë e më shume, dukej sikur i thërriste Qemalit për ndihmë. Po të lagej furra, qemeri do të shembej dhe puna mund të ndërpritej për më se një muaj, derisa qemeri të rregullohej përsëri. Ky mendim kaloi në trurin e tij me një shpejtësi të rrufeshme.

«Në sulm!» i tha vetes dhe u vërsul për nga dera. Me përgjegjësin e turnit, Idrizin, u morën vesh vetëm me një vështrim. Me këta të dy u bashkua dhe Ramadani, brigadieri. Që të tre së pari ju vunë punës me nxitim për të ndërtuar një shkallë, që ët mund të ngjiteshin në çati. Duart e

tyre lëviznin si të qenë mekanizma elektrike; të tre kishin vetëm një mendim: të rregullonin sa më parë çatinë e baxhos që të shpëtonin furrën.

Shkallën e pregatitën dhe e vendosën në faqen e murit. Morën secili nga një llamarinë dhe u ngjitën lart. Kur i treti, Ramadani, po hipte te streha, disa punëtorë të tjerë po i ngjiteshin shkallës.

— Eeej. Kthehuni! — U thirri atyre brigadierit. — Nuk kemi ku qëndrojmë të gjithë sipër çatisë. Mjaft jemi tre vetë.

— Zbrit ti, Ramadan, se do të ftohesh; zbrit ti, e të vij unë — u dëgjua një zë që nga poshtë.

— Jo, jo. Ju shkoni nëpër vendet tuaja — dhe Ramadani eci sipër llamarinave për te Qemali e Idrizi.

Në çatinë e baxhos ishin hequr tri copë llamarinë, tamam sa morën të tre shokët, kur u ngjitën lart. Tufani vazhdonte me atë furinë e mëparshme. Ata qëndronin shtrirë dhe mbaheshin fort me duar se mos rrëshqisnin. Avulli që ngrihej përpjetë, nga shiu që binte mbi qemerin e nxehtë të furrës, sa vinte e shtoej.

Të tre shokët, që lart nga çatia e baxhos, mundën të shikonin për një çast shokët e tjerë poshtë, të cilët gjithë ankth i mbanin sytë përpjetë.

Vendosja e llamarinave në ato shina hekuri të ngushta, ku mezi mund të qëndroje edhe ditën në kohë të mirë, qe shumë e vështirë.

Qemali e zgjatj llamarinën që mbante në dorë; deshi ta vendoste në vendin e dukur. Era e ngriti llamarinën dhe ja shkëputi nga duart. Ai u hodh që të kapte llamarinën dhe u rrëzua vetë,

ra shaluar sipër shinës së hekurt. Atje poshtë u ndie një «ah», që arriti tronditëse deri lart në çati. Qemali s'e lëshonte llamarinën nga duart dhe u kacavar me këmbë pas hekurit. Idrizi i vajti në ndihmë. Lllamarinën e tij ky e kishte vënë përfund trupit por, duke u zgjatur që të mbante Qemalin, pështa e trupit i anoi nga vendi i mbetur pa mbulesë.

Kjo histori do të kishte marrë fund me kaq, (të dy, Idrizi me Qemalin do të qenë rrëzuar sipër qemerit të furrës) të mos qe veprimi i shpejtë i Ramadanit, që e mbërtheu Idrizin prej këmbës së djathtë dhe e mbajti në vend. Shokët poshtë, që qëndronin si një masë e ngrirë, me forma të ndryshme, lëvizën si të çliruar nga një barrë e rëndë ndrydhëse e torturuese.

Qemali me Idrizin, të ndihmuar edhe nga Ramadanani u ngritën dhe zunë vendet e mëparshme. Era e pëplaste shiun si rrebesh mbi trupat e tyre. Pas asaj që ndodhi pak më parë, Qemali nxori mësim. E shtyri llamarinën rrëshqanas sipër çatisë, në mënyrë që era të mos mund ta ngrinte. E vendosi në vend dhe i hipi përsipër. Një rën pas tjetrës i vunë edhe dy të tjerat.

Shiut ju pre rruga. Mirëpo mbërthimi i llamarinave me bullona në shinat e hekurit qe i pamundur. Tufani uturinte. E gjithë ndërtesa gjëmonte nga zhurma e erës, që përplasej si dallgë e furishme.

Të tre shokët, në heshtje, pa folur asnjë fjallë filluan t'i mbanin llamarinat e sapovendosura me trupat e tyre.

Poshtë puna vazhdonte përsëri me ritmin e

zakonshëm. Pjesa e lagur u tha dhe avulli u pre. Por shokët poshtë, ndonëse të përqëndruar tek puna që bënin, mendjen e kishin lart, te të tre shokët mbi çati, të cilët po përlesheshin me tufanin. Herë pas here hidhnin vështrimin andej, se mos shikonin ndonjë ballonë që të lëvizte poshtë vrimës së ndonjë shine dhe, kur nuk shikonin një gjë të tillë, e merrnin me mend se shokët atje lart e kishin pisk me tufanin. Zërat e tyre të shqetësuar, në ndonjë rast kur era heshte qoftë edhe për një grimë, arrinin deri sipër baxhos.

Vetëm kur u siguruan se ujët nuk kalonte më nën llamarinat, të tre shokët u kujtuan për veten e tyre e panë se ishin lagur e bërë qull. Qëndronin të tre barkas dhe duart i shtrëngonin pas llamarinave të mbërthyera, që era nuk kish mundur t'i lëvizte dot nga vendi. Qemali në të djathtë, Ramadani në mes dhe Idrizi nga e majta. Era që vinte drejt grykës rrihte përpara trupin e shkrirësit dhe ja ngjishte fare pas trupit rrobat e lagura. Ai me të gjithë fuqinë e tij i shtrëngonte nofullat, që të mos i dridheshin nga të ftohtët. Mendimi i shkoi te brigadieri. Ramadani kishte kaluar një të ftohët para një viti. Qemali, duke u mbajtur vetëm me një dorë, me tjetrën hoqi peliçen e pambuktë, që kishte veshur sipër kominosheve dhe ja hodhi shokut.

— Mbaje për vete, se ty të kap era më fort aty — tha Ramadani dhe desh t'ja kthejë peliçen.

— Jo, jo, mbaje.

Përgjegjësi i turnit, kur pa këtë skenë, u tha dy shokëve:

— Ajo që na ngroh ne dhe që na mban edhe

të lagur këtu sipër në çati nuk janë peliçet dhe rrobot, se ato të gjitha janë bërë qull, por është ngrohtësia e zemrave tona...

Dy shokët e kuptuan sa të vërteta ishin ato fjalë dhe s'ngulën më këmbë për atë peliçe pambuku. Lllamarinat lëviznin prej erës dhe kërcisnin nën presionin e forcës së saj. Shiu përplasej me zhurmë mbi çati dhe mbi tre punëtorët, që me trupat e tyre ju bënë mburojë furrës së shkrirjes

Qemali përsëri mendonte për Ramadanin. Ai një vit më parë kishte kaluar një të ftohët... U agrit dhe u mbështet mbi bërryl, në ije, që t'i priste disi vrullin erës për te shoku i tij.

Tufani sikur e ngadalësoi pak forcën e mëparshme. Të tre shokët rrinin barkazi sipër llamarinave të pambërthyerë dhe duart i shtrëngonin fort pas çatisë. Tani që shiu dhe era për një çast u vunë në dremitje, mendimet e tyre merrnin hov.

— Shokë, të mbërthejmë bullonat! — tha Idrizi.

Të tre u vunë në lëvizje. Lllamarinat i kishin vrimat e hapura. Por s'kishin vënë akoma as dy bullona në secilën llamarinë, kur tufani ja dha i fortë përsëri mbi çati me tërsëllimë. U shtrinë prapë në pozicionin e mëparshëm.

Shokët poshtë i hetuan lëvizjet e shokëve dhe e ndjenin veten më të lehtësuar. Kur pikasën se tufani po niste përsëri, shqetësimi ua përshkoi çdo qelizë.

Te streha e çatisë, ku qenë vendosur shkallët, llamarinat kërcitën. Ishin tre punëtorë të tjerë që vinin për të zëvendësuar shokët.

— Na e lini neve vendin tani, zbrisni poshtë, shokë! — Ishte zëri i Fatmirit.

— Po kush ju tha juve të vini këtu? — foli Idrizi.

— Kush na tha? Po juve kush ju tha?

— Ne erdhëm të parët — tha Ramadani. — Ju shkoni vazhdoni punën! Ne nuk ngrihemi, se era i luan llamarinat nga vendi. Apo jo, Qemal?

— Ashtu është.

Fatmiri me dy të tjerët u munduan t'u mbushnin mendjen, por qe e kotë. Ata u kthyen.

Pas tre çerekë ore tufani ndaloi. Qemali, Ramadani dhe Idrizi i mbërthyen llamarinat me bullona pas shinave dhe zbritën poshtë.

Shkrirësi shkoi te dera e furrës. Brenda në furrë kishte mbetur edhe pak brumë pa e hequr. Afshi i nxehtë ja thau rrobat. Ky avull e bëri që t'i hedhë sytë mbi qemer. Atje çdo gjë ishte në rregull.

Qemali shikonte brumin e nxehtë që pakësohej në furrë, ndjente afshin e ngrohtë nga dera e furrës dhe një ngrohtësi që i buronte nga zemra.

HALL ME TULLAT E BARDHA

Eh, tullat e kuqe! Vërtet lodheshe duke e bërë murin me to, por s'i kishe këto telashe që të hapin tullat e bardha. Tulla silikate ua kanë vënë emrin. E ç'më duhet mua si u thonë? Po të më kishin pyetur mua, tulla të sëkëlldisura do t'i quaja se, sa herë punoj me to, sëkëlldi më sjellin e çfarë sëkëlldije se...

Se, që ta dini edhe ju, unë isha mësuar të punoja me tulla të kuqe. Ua kisha marrë mirë dorën. Tamam si ato zura t'i vendos edhe tullat e bardha atë ditë kur m'i dhanë për herë të parë. Të bukura janë lanetet, të bukura fort: të bardha, të lëmuara, ta kënda t'i hedhësh hopa nëpër duar. E ja kisha marrë një të fëshkëlyeri atë ditë, që shkonte për bukuri me lëvizjet që bëja. Hop — rrëmbeja tullën silikate, hop me një frymë llaçin me mistri, hop vetëtimthi sipër llaçit bukuroshen dhe fiu-fiu fishkëllima. Kur do ti, me të mbaruar rreshtin e tretë, më doli përpara teknikja. Doli dhe shtrembëroi buzët. Ajo mblodhi buzët, mua fap m'u pre fishkëllima. M'u pre, se e di unë ç'do të thotë t'i shtrembërojë buzët ajo. Se, po shtrembëroi buzët, pisk e ke. E kisha provuar vetë,

kohë më parë me kornizën e dritares. Ngaqë ngutesha të tejkaloja normën dhe s'para vija re punën që bëja, pjerrësia e kornizës së dritares më doli nga ana e brendshme, nga ana e dhomës, dhe kështu shiu do të kullonte brenda dhomës. Hej, ç'më gjeti mua të ziun atë ditë. T'u mblodhën të gjithë mjeshtrit e ndërmarrjes rrotull kornizës. si të ish ndonjë gjë e rrallë, e t'ja filluan me kritika, thumba e rromuze, sa jo vetëm balli, por tërë trupi m'u mbush me djersë.

Sidoqoftë, atëhere punohej me tulla të kuqe, që s'kishin huqe si këto tullat e bardha. S'ke ç'u thua, të bardha, të bardha, por e paskeshin patur vërtet bishtin prapa si të dardhës. Ja, sapo nisa të punoj me to, sapo bëra vetëm tri sërë, teknikja shtrëmbëroi buzët.

E vështrova si i ngrirë. Ajo ma bëri me shënjë të afrohesha. Kapëtova murin dhe i vajta pranë tërë siklet.

— Pa shiko ç'ke bërë? — Më tha.

Hodha vështrimin te muri që kisha nisur të ngrija. Nuk e di se si, po edhe mua m'u shtrembëruan buzët: m'u bë sikur në ato tri sërë, kish plasur sherr i madh midis tullave, aq keq qenë ngërthyer njëra me tjetrën.

— Hall me këto tullat e bardha — mërmërita dhe u përpoqa të dukem i dëshpëruar.

— Ashtu?!

— Po, po: nazelie të mëdha. Nuk bëjnë pesë para — sikur mora pak zemër, po fytyrën ama e pikëllova akoma më shumë.

Teknikja ngriti vetullat, më pa nga koka gjer te këmbët dhe m'u përgjegj:

— Mundet. Ndoshta vërtet nuk bëjnë as pesë para. E di çfarë?

— Hë?

— Pse s'merr nga ato të Harunit?

«Më duket se e hodha hendekun», fola me vete disi i lehtësuar dhe me shpejtësi hodha sytë nga Haruni, që po ngrinte një mur pak më tej. Po i hoqa vetëtimthi që andej, i kalova te teknikja, pastaj përsëri te Haruni, prapë te teknikja e te Haruni, që po vendoste njëra pas tjetrës me përpikmëri e aq bukur, sa ta kish ënda të shihje tullat, tullat e bardha silikate.

«Ma punoi shejtanka!»

Unë nuk bëja, jo tullat e bardha.

E si të mos mjaftonte kjo, erdh e t'u mblodh e gjithë brigada rrotull murit tim dhe ja filluan: bamp këtu e bamp atje, tamam në ato pjesë ku tullat qenë ngatërruar aq keq njëra me tjetrën, sa s'e merrte vesh qeni të zonë.

Pas kësaj ngjarje i thashë vetes:

«Vërë mend, që të mos përvëlohesh prapë!»

Dhe që të mos përvëlohesh nga qulli, zura t'i fryj edhe kosit. E çfarë të fryrë se. Rrija katër-pesë minuta me një tullë, veç e qaja, ama.

— Ja kjo është punë që të kënaq — thosha me vete. — Budalla paske qenë. Ngryse or ditën me 100-120 tulla, kurse zotrisë tënde i hante kurri me dy metro e gjysmë kub me tulla të kuqe në ditë. Oh, oh, sa mirë!

Ç'e do, kjo kënaqësi nuk zgjati as disa ditë. E ku të lënë rehat të gëzosh të tilla gjëra, e ku të lë plani, norma, rendimenti; jo një çerek metro kub, por tre çerek metro kub duheshin bërë në ditë.

E ngrita zërin, e ngrita fort, bile:

— Qamet i zi! Si mund t'u bëkan tre çerekë metro kub në ditë? S'janë tulla të kuqe. Këto janë tulla të bardha, o shokë; o cilësi, o normë!

Dhe e ngrita se kisha me vete edhe nja dy shokët e mi. Por, në vend që të më dëgjonin, më tregonin me gisht Harunin. Të ishte vetëm Haruni, do që gjysma e së keqes, por, si për inat, nga një u bënë shumë Haruna. Jo vetëm kaq. Unë ngulja këmbë në timen, ata djaj Haruna shtonin volumin, gjersa arritën të bëjnë një metro e gjysmë kub brenda tetë orëshit.

Megjithatë, ata të tyren, unë timen. Ata flisnin e kërkonin të më mbushnin mendjen, ata përpiqeshin të më tregonin se mund ta arrija normën e tyre, po unë s'tundesha.

— Mirë, o byrazer, ju që jeni më të zot, shkoni më përpara. Unë nuk ju ndaloj. Po, sa për vete kaq e kam takatin, kaq më jepet.

— Mor po, edhe xha Lazja, që u plak fare dhe tani u jep mësim nxënësve muratorë, bën më shumë, ngulnin këmbë pa u mërzhitur shokët.

— I lumtë — u përgjegjesha edhe unë pa u mërzhitur.

E pse të mërzhitesha? Në fund të fundit (këto të fshehta nuk ja thosha askujt), nëse punoja pak unë, punonin shumë anëtarët e brigadës sime dhe rroftë norma kolektive! Apo jo?

Para pak ditëve më thanë:

— Sot do ta ndërtoni murin çift, bashkë me Harunin. Do të filloni nga të dy cepat e kundërt dhe do të takoheni në pikën e mesit.

— Si ta kërkojë e mira e punës — u për-

gjegja dhe fillova t'i vendos nga cepi im tullat silikate. Pranë nesh punonin shokët e brigadës dhe brigada të tjera.

Kur Haruni arriti me tullat e sërës së parë në pikën e mesit, unë doja akoma nja dy metro. Haruni më vështroi dhe foli:

— Sa të arrish ti gjer në mes, unë mund të pi rehat një cigare, eh?

Unë nuk ju përgjegja. Folën të tjerët:

— Ke kohë të pish dy, Harun. Sot do të kalosh edhe normën e duhanit.

Më dogjën fjalët e tyre, po e mbajta veten dhe bëra sikur nuk i kuptova thumbat. Mirëpo ata s'pushonin. Kur filloi radha e dytë e tullave dhe Haruni arriti në pikën e mesit, unë isha më afër tij se sa kur vendosëm sërën e parë. Pa e kuptuar as vetë i kisha lëvizur duart më shpejt, i nxehur siç isha nga thumbat e shokëve.

— O Harun, — i thirrën ata — mendo edhe për ne, na e jep hua shokun tënd, që të mund të pimë edhe ne duhan, se na u ça hunda e shkretë, kur nuhasim erën e cigares tënde.

— Jo, or jo, — u përgjegj Haruni. — Ju mund të më quani individualist, por këtë radhë më pëlqen të mendoj vetëm për vete. Megjithatë, kur të vijmë në sërën e tretë dhe të pi cigaren rehat-rehat, atëhere do të vendos, t'ju jap shokun apo jo.

«Prit, se ke për të pirë cigaren» shfryva dhe m'u ndezën krahët.

Punoja dhe me bisht të syrit vështroja Harunin. Kur ai arriti në pikën e mesit, edhe unë po vendosja tullën e fundit aty. Ai bëri sikur s'e

vuri re; ndoshta priste sërën e katërt, por unë s'e lashë të pinte cigare as në të pestën, të gjash-tën gjer në fund.

— Eh, — i thashë, — u kënaqe me duhanin?

— Jo, — m'u përgjegj, — por u kënaqa me punën tënde, se bëre po aq normë sa dhe unë, sa edhe të tjerët. Tani pi një cigare nga të miat, — dhe vështroi andej nga i kisha sytë edhe unë, nga tullat e bardha, tullat silikate.

BRIGADA E SHAKAXHINJVE

Nikolla i gjeti punëtorët të veshur me rrobat e punës në «dhomën e pushimit», siç e quanin ata. Kjo dhomë qe rregulluar me disa stola e tryeza. Në murin kundrejt derës qenë vendosur një sërë fotografish. Në krye të dhomës ishte rafti i ndihmës së shpejtë dhe sipër tij një bust mermeri i shokut Enver, i gdhendur me daltë. Të gjitha këto Nikolla i vuri re me një vështrim. Për këto nuk i kishin treguar. Gjithashtu ai nuk e dinte se bustin prej mermeri të shokut Enver e kishin bërë njëri prej ustallarëve të asaj brigade, Zefiri. Emrin Zefirit ja kishte dëgjuar, se ai qe bërë i njohur në gjithë ndërmarrjen si specialist i zoti. po si fytyrë s'e njihte dhe nuk e dinte se punonte në atë brigadë.

Anëtarët e brigadës e kishin marrë vesh se atë ditë vinte tekniku i ri (pasi ai qe ishte më parë kishte shkuar në hidrocentralin e Vaut të Dejës) dhe e pritën, qe të takoheshin e të njihehin me të.

Nikolla hyri në derë dhe pyeti:

— Këtu është brigada.. ?

— E shakaxhinjve — ja priti Faruku, të cilit

shokët i thërrisnin «shtatanik», pasi nuk i durohej asnjëherë pa folur.

Nikolla qeshi si i zënë ngushtë. Ata u ngritën dhe i dhanë dorën njëri pas tjetrit. Tekniku deshi t'ja mbante dorën më tepër se të tjerëve asaj flokëverdhës, por dora e tjetrit, që ju zgjat nga e djathta, e bëri që ta lëshonte.

Pasi u takuan, punëtorët u ulën prapë nëpër stola. I bënë vend edhe Nikollës. Njëri prej pjesëtarëve të brigadës, ai me kominoshe në bojë bari, u ngrit të flasë. Tekniku mendoi se ai do të qe Besniku, brigadieri. Vetëm këtë emër dinte. Ja kishin thënë në kantier. Por aty e mori vesh se ai që u ngrit për të folur ishte Zefiri, i cili qe ngarkuar si anëtar i komitetit profesional të kantierit të prezantonte teknikun e ri me brigadën.

— Shoku që posa erdhi — filloi Zefiri — është gjeometri që do të drejtojë punimet në objektin tonë...

— Me leje? Një vërejtje — kërceu Faruku.
— Le të kërkojë të falur për vonesën.

— Pusho njëherë, mor i uruar! — e qortoi një tjetër.

Nikolla shikoi orën. Ishte shtatë e dhjetë minuta. I kaloi një e rrënqethur nëpër trup e faqet ju bënë si t'ja kishte fërkuar njeri me gjethe thane. Nuk i kishte vënë rëndësi vetë asaj pune. E dinte se punëtorët shkonin në objekt me një maqinë të ndërmarrjes, por i kishte ardhur më mbarë të shkonte me autobus. Sidoqoftë dita e parë, dhe i dukej si jo e hijshme të takohej e të njihej në rrugë me punëtorët që do të drejtonte. Pastaj edhe pse të vinte pak si vonë, ç'bëhej?..

Mirëpo ja ku të del ai Faruku e të faros me ato fjalë si farmak.

Zefiri harroi se çfarë duhej të fliste.

— E o, shtataniku na ngatërroi — tha usta Veliu, një burrë sipër të pesëdhjetave. — E di, Zefir, unë kam një propozim — vazhdoi duke u ngritur më këmbë. Farukut t'ja mbyllim gojën me një shami, sepse ndryshe prapë do na ngatërrojë.

Krisi e qeshura. Nikolla për një grimë ndejti si i hutuar, pastaj e qeshura e përzjeu edhe atë me të tjerët. Tek shikonte të qeshnin gjithë ato fytyra që sapo i shihte, harroi se një minutë më parë ndodhej në pozitë të vështirë.

Kjo e qeshur e shkriroi edhe Zefirin. Ai vazhdoi fjalinë atje ku e kishte lënë:

— Unë shkova atje në kantier që të njihesha me shokun teknik, po nuk u takuam. Drejtoria e kantierit e ka caktuar këtu përgjegjës për punimet, po për këtë duhet edhe aprovimi ynë, i kolektivit të brigadës...

— E po, sikur të gjithë t'i nxirrni tani shamitë e të më lidhnin gojën, nuk rri dot pa folur — kërcëu përsëri Faruku. — Ku e njohim ne, mor vëlla, që të japim aprovimin.

U ndjenë disa të qeshura, por i ndërpreu zëri i fortë i Zefirit.

— Faruk! Mos na e humb kohën kot!

Tjetri diç u bë gati prapë të fliste, por vërejti se sytë e të gjithëve i thoshin të heshte.

— Është e drejtë që ne nuk e njohim shokun teknik — vazhdoi Zefiri, — prandaj dhe aprovimi nga ne kërkohet, pasi ta kemi njohur. Dakord?

— Dakord — qe përgjegja e njëzëshme.

— Atëhere në regull. Projektet dhe instrumentat teknike, besoj se të kanë thënë, do t'i marrësh në dorëzim nga kryeinxhinieri i kantierit — ju drejtua Nikollës.

Pas kësaj, të gjithë me veglat e punës nëpër duar u drejtuan nëpër vendet e punës. Ndërtesa kishte mbaruar si karabina, brigada merrej me suvatimin e dhomave nga brenda dhe me shtrimin e pllakave.

Nikolla priti sa të fillonin nga puna, pastaj e thirri brigadierin dhe i tha që së bashku të kontrollonin punimet.

— Me gjithë qejf — qe i gatshëm Besniku.

Teknikut të ri i bëri përshtypje qysh sapo hyri në ndërtesë cilësia e mirë e suvatimeve. Edhe muret nga jashtë ishin bërë mirë por si i thonë fjalës, suvaja është si këmishë për ndërtesën. E, një këmishë të hekurosur ta pëlqen menjëherë syri, kurse po qe rrudha, rrudha... Por sidoqoftë duhej kontrolluar mirë; syri të gënjen. Mund t'i jetë dhënë llustër e bukur me përdaf dhe megjithatë, të ketë shtrembërime. Mastari, plumbçja, terezia e ujit e thonë të vërtetën...

Ndërsa ai mendonte këto, brigadieri erdhi përpara tij me veglat që i nevojiteshin për të bërë kontrollin.

E filluan nga dhoma pranë hyrjes.

Nikolla i kontrolloi njëherë katër faqet e murit dhe filloi për së dyti. Kjo ishte diçka që me gjithë mend të çudiste. E vinte mastarin në të gjitha drejtimet: vertikal, horizontal, në mënyrë diagonale, qoshe më qoshe. E njëjta gjë: mastari

puthitej plotësisht pas faqes së murit. S'kishte asnjë boshllëk ose ndonjë të ngritur të vogël. Dorë i thonë dhe gjatë fërkimit me mallë apo përdaf mund të bëhet ndonjë gabim. Mirëpo jo, dhoma ngjante si një kuti e madhe e prodhuar nga ndonjë fabrikë. Ta masje kudo, në të katër qoshet, në meset: tetë metro e gjysmë me pesë. E provoj vertikalishtin e mureve me plumbçe; as edhe milimetri nuk lëvizte. Morën së bashku me Besnikun një kambalecë në formë tryeze dhe hipi në të për të vërejtur tavanin. I mbeti leveli (terezia e ujit) atje ku e puthiti. Ajo dhomë ishte një model suvatimi. Teknikut të ri ju ndeh një keqësi; i vërshoi nga thellësi e trupit dhe ju pasqyrua në fytyrë. Kishte të bënte vërtet me njerëz të kujdesshëm, që ishin ustallarë të zot që e donin punën dhe punonin me kënaqësi. Këtë e tregonte cilësia e punës në dhomën, të cilën ai po e kontrollonte dhe po mbetej shumë i kënaqur.

Vazhdoi kontrollin edhe nëpër dhomat e tjera. Mendoj njëherë se tek dhoma e parë mund të ishin treguar më shumë të vëmendshëm, se në çdo fillim puna kapet më me qejf. Por jo, edhe në dhomat e tjera e njëjta punë, i njëjti kujdes, e njëjta cilësi. Nikollës i nxori kokë diku në një qoshe të ndërgjegjes së tij mendimi që të gjente goftë edhe një të metë të vogël. Ky mendim e ndiqte nga dhoma në dhomë dhe sa vinte sikur rritej pak nga pak, po i kalonte caqet e një mendimi të shkrepur ashtu kot, po kthehej në një dëshirë. E po duhej gjetur edhe ndonjë e metë që, në fund të fundit, të përlligjte punën e tij edhe ai. Ndryshe s'kishte kuptim; ç'punë do të bënte

ai si teknik? Për atë ishte, të konstatonte të metat dhe të luftonte për zhdukjen e tyre. Por ja që tekniku para tij dhe këta punëtorë që punonin në këtë ndërtesë kishin luftuar siç duhet kundër të metave. Megjithatë s'i mbushej mendja se në punët e ndërtimit mund të eliminohen plotësisht të metat. Është çudi nganjëherë. Nuk i beson aq shumë një gjëje që e shikon vetë me sytë e tu dhe e aprovon me vetë ndërgjegjen tënde, por kapesh pas ndonjë mendimi që të ka ndjekur pas me vite, mendim me të cilin je rritur. Kështu ndodhte në ato çaste edhe me Nikollën.

Mbaruan së kontrolluari dhomat e përfundura dhe hynë në ato ku vazhdonte puna. Tani sikur u bë ca i padurueshëm. E vinte mastarin vetëm një herë në një faqe muri, e hidhte vështrimin përreth dhomës dhe kalonte në tjetrën. Në dhomën ku punonte Faruku u ndalua më shumë se te të tjerët. E shtynte diçka nga përbrenda, as ai vetë nuk e dinte tamam se çfarë.

Atij, Farukut, medoemos duhet t'i gjente ndonjë gabim në punë. Mjaftonte që t'i tërhiqte një herë vërejtjen. Do të lindte pastaj që nga kjo vërejtje Faruku do të kërcente përpjetë, atëhere teknikut i jepej mundësia që ta qortonte mirë e nërë. T'ja bënte të qartë se në fund të fundit në atë objekt ishte ai, Nikolla Lisi, përgjegjës për punimet. Mirëpo në çast i ra ndër mend se nuk qe dhënë akoma aprovimi nga kolektivi i brigadës dhe ju bë sikur ju rrëzuan të gjitha ato që mendonte.

Me Farukun punonte edhe ajo leshverdha, Laura, kështu e kishte emrin. Mbi të gjitha aty

të bënte përshtypje pastërtia, sikur të qe mensë e jo një dhomë në suvatim e sipër, ku përdorej llaçi.

— Ke qejf të rrish këtu, aq pastër është — tha Nikolla.

— E po, s'do as mend as kalem kjo punë, është dora e kujdesshme e femrës që vendos rregull e pastërti — ja ktheu Faruku.

Të katër vunë buzën në gaz.

Kjo buzëqeshje nuk ja ndaloi mendimin teknikut që me çdo kusht të gjente ndonjë yçkël. E kontrolloi dhomën (pjesën e suvatar) gati pëllëmbë për pëllëmbë. Asnjë vërejtje.

— Ju lumshin krahët — tha dhe doli. Ç'të bënte, kot s'mund të fliste, se hajde të hyje pastaj në gojën e Farukut.

Kështu kaloi dita e parë.

Të nesërmen erdhi kryeinxhenieri i kantierit e i bëri dorëzimet. Atë ditë Nikolla u muar nja dy orë me përcaktimin e kuotës për shtrimin e pllakave, ose më mirë të themi kontrolloi nëse ishin dhënë mirë kuotat. Konstatoi se çdo punë qe kryer me saktësi. Pjesën tjetër të kohës shkoi sa tek një grup punëtorësh te tjetri, hipte e zbrishte nga kati i parë në të tretin e anasjelltas; herë në heshtje, herë duke vërshëlyer. Ç'të bënte? Të rrinte në një vend mërzitej. Puna e tij qe të mbi-këqyrte vazhdimisht cilësinë e punimeve, po dhe për këtë nuk qe nevoja... Të sillej ashtu kot duke vërshëlyer, prapë sikur nuk shkonte. Një ditë edhe ngrysej në atë mënyrë, por jo disa muaj. Po punëtorët ja hoqën edhe atë siklet. Në mëngjezin e ditës së tretë, sipër tryezës, përpara vendit ku

ai u ul qysh ditën e parë, i kishin vendosur një palë vegla suvatimi dhe pranë tyre një copë letër ku shkruhej: «Lodra zbavitëse për ata që mërzi-ten». U mërzi-ten pak nga kjo shaka, por dhe mërzi-ten vetëm vetes ja tregoi. U kujtua shpejt se bënte pjesë në «Brigadën e shakaxhinjve».

I mori veglat dhe nisi të punonte me usta Veliun, i cili ishte vetëm atë ditë dhe kishte nevojë për një ndihmës që të bënte përdaf mbrapa tij. Nikolla kishte mësuar të suvatonte qëkur kishte qenë nxënës në teknikum. Ja kishte marrë dorën disi.

Mirëpo usta Veliut nuk ja dinte huqet. Ai e shikoi njëherë punën që bënte tekniku pas tij dhe hoqi disa viza në murin e porsasuvatuar. Ato viza thoshin që përdafi duhej përsëritur. Hera e parë që Nikolla lexonte një shkrim të tillë, po ishte shkrim i lexueshëm. Kur e mbaroi punën për së dyti, e pyeti ustanë:

— Xha Veli, po tani si të duket puna ime?

Tjetri nuk i dha përgjegje; vetëm i shpejtoi duart dhe e la Nikollën shumë mbrapa. Edhe këtë përgjegje pa zë tekniku i ri e kuptoi. Do të thoshte se «xhajë» që ai që mbetej mbrapa në punë.

Kështu ju fut punës tekniku Nikolla Lisi. Punonte së bashku me punëtorët lodhej e kënaqej. E shihte se çdo ditë futej më thellë midis atyre njerëzve. I pëlqente puna e tyre, shakatë e tyre...

... Një mëngjez, kur po vinin me maqinë për në punë, usta Veliu futi dorën në xhep dhe nxori andej disa karamеле.

— M'i ka dhënë Izeti që t'ua ndaj shokëve, sepse u martua — tha. — Kishte dalë në rrugë qëllimisht për të më dhënë karamеле. Vetë, meqë është dhëndërr i ri, sot nuk vjen në punë.

Nikolla e njihte Izetin, atë punëtorin e gjatë, që i kishte kaluar të dyzetat. Nga shokët kishte mësuar se Izeti qe beqar. Ata e uronin gjithnjë sho-shoqin si me shaka: «Hajde, në dasmë të Ize-tit»! I shkoi njëherë ndër mend se mos qe ndonjë shaka nga ato të zakonshmet kjo ndarje e karamele-ve por, kur pa që të gjithë të tjerët i morën, e mori edhe ai. E hapi letrën me kujdes kur: në vend të karameles ishte një gur i vogël sa një kokërr bajame. E flaku atë copë guriçkë me sa fuqi pati dhe letrën e bëri thërrime së ngjeshuri me këmbë pas dyshemesë së karrocërisë. Atë çast shikoi për-reth dhe u ndesh me vështrimin e usta Veliut. E mblodhi veten. Nuk deshte t'i jepte të kuptonte që u dëshpërua nga ajo shaka.

Pas disa ditësh vajti të punojë me Laurën, sepse edhe Faruku kishte shkuar në zbor. Që ta themi hapur, Nikollës i erdhi mirë që ju dha ky rast. Kishte vërejtur se vajza flokëverdhe sillej një-soj me të gjithë, punonte njësoj si të gjithë dhe bënte shaka njësoj si të gjithë. Duke punuar bashkë me të, i bënte vazhdimisht muhabet dhe i maste mirë fjalët para se t'i thoshte, në mënyrë që t'i jepte njëfarë rëndësie vetes. Ja solli fjalën rreth e rrotull e më në fund i tha se po të donte ajo, ata mund të takoheshin në mbrëmje, pas pune.

— Po pasi të takohemi, ku ke ndër mend të shkojmë? — e pyeti Laura.

Ai s'e priste këtë pyetje. Mblodhi supet.

— Ku të duash ti — tha, — shkojmë në kinema.

— Mirë — foli ajo.

— Po atëhere, t'i pres biletat unë.

— Jo, jo, atje e vendosim.

E lanë të takoheshin në orën 7-të. Ai vajti në vendin e takimit më 7-të pa pesë. Më 7-të pa një minutë erdhi Laura me gjithë Farukun, të cilit i kishte futur krahun e majtë.

— I fejuari im — ja prezantoi Nikollës.

Ai qeshi. Në të vërtetë e mori për shaka. «Një herë e urova Izetin më të thatë» tha me vete.

— Hë mo, të ndaluar nga doktori e ke që nuk na uron — foli Faruku, që kishte marrë një pamje serioze. Serioziteti i atij çasti binte në kontrast me fjalët për të qeshur që fliste.

Atëhere Nikolla tha me zë atë që pak më parë e shkoi nëpër mend.

— Një herë e urova për së thati Izetin unë...

Faruku nxori një pako llokume nga një letër e bardhë, ku e kishte mbështjellë.

— Këtë për sot — i tha. — Nesër në brigadë e ke pjesën bashkë me shokët.

Nikolla s'po dinte si të vepronte.

— Po si kështu?... Kur kështu?..

— Kjo punë është vendosur me kohë, sonte i erdhi rasti të bëhet e njohur, të shpallet — ja priti Faruku.

— Biletat i kemi prerë për më 7-të e gjysmë — tha Laura. — Bëjmë një xhiro të shkurtër, pastaj shkojmë në kinema.

Kështu u fut në jetën e brigadës së shakaxhinjve edhe Nikolla.

NDIHMËSI IM

Ky tregim zë fill qysh ditën e parë që Alfred Dhani erdhi të punojë me mua. Para se të vinte tek unë Alfredi punonte si ndihmëselektricitist. Qëndrimi i tij në brigadën e elektricitistëve qe bërë i padurueshëm. Bënte mungesa në punë dhe, kur vinte, rrinte gjithë ditën duke u vërtitur, sillej si kapadai ndaj shokëve dhe grindej vazhdimisht me ta. Por ajo që u vuri kapakun të gjithave qe, se Alfredi nuk sillej mirë me disa vajza, që kishin ardhur për të kryer praktikën si elektricitiste. Ato u ankuan. Kjo zemëroi gjithë shokët e brigadës, të cilët vendosën ta largojnë njëherë për njëherë nga brigada e tyre. Kështu ndodhi që Alfredin e caktuan të punojë me mua si ndihmësuvator.

Ditën e parë thujse nuk zuri punë me dorë. Ishte bërë dora e parë e suvatimit, astari, siç i themi ne dhe, do t'i jepej dora e dytë, ose finua, siç quhet në gjuhën e suvatorëve. Punonim sipër në skelë. Unë jepja fino, ndërsa Alfredi rrinte me duar në xhepa dhe vërshëllente duke vështuar nga dritarja. Të them të drejtën, më vinte plasje nga ai qëndrim i tij prej teveqeli. Mendova t'i flisja, ta shaja e ta bëja qepaze, apo ta rrëmbeja

për krahu e ta flakërija nga skela, po e mposhta zemërimin. Për një çast ndalova dhe po e vështroja. Kishte një fytyrë mjaft tërheqëse. Nga fytyra ja qepa sytë te flokët: ca flokë të zez e kaçurrella, që kishe qejf t'i shikoje. Edhe trupin e kishte të hedhur dhe të zhdërvjellët. «Epo, s'ke ç'i bën! Mendje e keqe në trup të bukur» arësyetova me vete dhe vazhdova punën. Mbas pak s'm'u durua dhe i fola:

— Si kujton ti, Fredi, ne që punojmë si suvatorë, mos jemi më të këqinj se elektrikistat?

— Jepi, jepi asaj mistrisë atje ti, se atë di të bësh, pa për gjë tjetër s'merr vesh! mua më kanë sjellë këtu për inat, gjoja për t'u ndrequr, por më i keq në u bëfsha, se më i mirë, ka marrë fund, s'bëhem.

— Po të punosh, do të bëhesh më i mirë, do të bëhesh zot i vetes, do të kuptosh...

— Qenkërke i mirë për citate ti, po për fat të keq, nuk e kam marrë bllokun me vete që t'i mbaj shënim.

— Sa rri aty kot, me duar në xhepa, pse nuk fillon nga puna? E sheh mistrinë, ty të pret. Edhe asaj i vjen keq që e ke lënë ashtu si jetime. Hajde, Fredi, lëri ato, mëso të suvatosh dhe do ta shohësh se do të të pëlqejë puna.

Mirëpo ai, në vend që ta merrte mistrinë, i këputi një shqelm dhe mistrria duke tringëllitur ra nga skela poshtë.

Vendosa të mos e shtyja më tej «edukimin» e tij. E shikoja se në vend që të afroheshim, largoheshim më shumë nga njëri-tjetri.

Vetëm kur prisha skelën dhe nxora lëndën e

drurit nga dhoma, ju dha Alfredit të më ndihmojë. «Kush e di mendova, ndoshta i erdhi keq për mua». Dërrasat ishin të rënda dhe s'do mundja t'i hiqja vetëm. Ai vazhdimisht ruhej se mos i bëheshin me llaç teshat e trupit.

Ditën e dytë dukej pak si më i çelur në fytyrë. Kishte veshur një palë rroba të përdorura. Pra, kishte vendosur që t'i shtrohej punës. Përsëri do të jepnim fino, se dorën e parë të pjesës nën skelë e kisha bërë që mbasditen e ditës së kaluar.

Unë fillova nga puna, kurse ai po më bënte sehir. Nuk i fola. Prisja se çfarë do të bënte.

— A të filloj të jap përdaf? — foli, mbasi ndejti për një farë kohe më këmbë.

— Edhe pret — ju përgjegja i gatshëm dhe fillova t'i tregoja si duhej të punonte. Mbas një ore dukej se kishte zënë t'ja marrë dorën punës dhe tërhiqej mbas saj. E vëreja dhe kënaqesha. Por gëzimi im nuk zgjati shumë.

— Kjo dreq punë të merr shpirtin — dhe duke thënë këto, e përplasi përdafin me inat tek muri. — Ti punon si i tërbuar, dhe unë të ndjek mbrapa si i çmendur. Hej, dreq o punë! Po kur më ardhka inat të ma kalosh! Shyqyr që s'më mban shumë kjo sedër! — Dhe u ul te dritarja. — Hajde ta ndezim një herë — tha duke nxjerrë paqetën nga xhepi.

— E ndezim — i thashë duke e marrë cigaren, por ta pimë duke punuar.

— Ehu, zure prapë ti! Unë do ta pi rehat këtë cigare, sikur të përmbysset.

Bëra sikur s'e dëgjova. Ndhimësi im e piu cigaren e parë, e fiku edhe të dytën dhe, ende

vazhdonte të rrinte ulur. E mora përdafin vetë. Duke punuar, e shihja me bisht të syrit dhe vura re se nuk i erdhi mirë që e mora unë përdafin, po prapë nuk luajti nga vendi. E ndiqte me sy dorën time, që ecte poshtë e lart mbas faqes së murit. Një ndjenjë pendimi i ndryshonte heraherës shprehjen e fytyrës. Dukej se kokëfortësia grindej me urtësinë. Përtacia donte t'ja zinte rrugën zellit për punë. Pavendosmëria lëkundej. Më në fund u ngrit dhe e mori përdafin. E zuri pak si me përtim, pastaj derrçe, duke synuar të më arrijë. Punonte me zell dhe me kujdes. Cilësia ishte shumë e mirë për një fillestar. Gëzimin që ndjeja unë në ato çaste, mund ta kuptojë fare lehtë ai që ka parë se si një pemë, e cila më parë nuk prodhonte asnjë kokërr, fillon të lulëzojë, të çelë burbuqe. Alfredi e kishte përqëndruar të gjithë vëmendjen tek puna, por një grimëz llaç i ra në sy. Ai e flaku përdafin, duke këputur një të sharë pa adresë.

— Mos e fërko syrin, se të dhemb më shumë
— dhe ja zura duart.

— Më lërë, të martë dreqi ty, suvatimin dhe atë që ka shpikur suvatimin! — Duke shfryrë desh t'i lironte duart, po unë s'e lëshoja.

— Mos e trego forcën me një gjysmë qorr, po prit të më shërohet syri. Lëshomi duart!

— T'i lëshoj, po të mos e ngacmoh syrin.

— Mirë, nuk e ngacmoj.

Mbas pak syri ju lehtësua dhe Alfredi u qetësua.

E kisha vënë Alfredin për të rregulluar qo-shet e një dritareje. Vendosa të mos i ndërhyj. E përfundoi dritaren. E provoi nëse vinin drejt qo-shet dhe vura re se mblodhi buzët. E prishi me zemërim dhe filloi përsëri nga e para. Edhe herën e dytë nuk u kënaq, se ç'murmuriti disa të shara nëpër dhëmbë dhe e prishi përsëri. Kur e shikoja që e rrëzonte llaçin me gjithë atë inat, mendova se do t'i hipin kacabunjtë e do t'i flakte veglat për tokë. Po ai e rregulloi për herën e tretë, pa ndezur asnjë cigare gjatë gjithë kohës. Djersët i shkollnin çurk. Vetullat thua sa s'i puqeshin me njëra-tjetrën. Kur e mbaroi dhe e shikoi se puna i kish-te dalë mirë, padashur ja bëri: — Hopa, tani po!

Në atë kohë erdhi normistja, për të na treguar ditët e punës gjatë pesëmbëdhjetëditëshit. Alfredi kishte 27 orë më pak nga unë.

— Kësaj radhe po të presim vetëm ditët që ke munguar dhe të paralajmërojmë që të mos e përsëritësh më, — i tha normistja, — ndryshe do të marrim masa.

— Ohu, na plasët me këto masa — kërceu Alfredi, — merr masa sot, merr masa nesër, po rrobat kur do të m'i prisni?!

— More, po a e di ti, ç'do të thotë disiplinë në punë, apo jo?

— Jo, moj shoqe, vetëm ti që më bredh nëpër objekt me fund zving e me një laps sa një hosten në dorë e di — ja ktheu Alfredi, duke shtrembëruar fytyrën dhe duke holluar zërin si grua.

Normistja ja hodhi sytë nga koka te këmbët.

— E ç'më shikon — ja priti Alfredi, — s'ta mbush synë?

— Mjaft, Fredi, mos e prish gojën — i fola unë.

— Po, ashtu thua ti, sepse je në regull për vete.

— Është në rregull, se ka punuar — i erdhi në shteg normistes, — jo si ti.

— Po, moj turtulleshë, po. — dhe qëllimisht fshiu me dorë ballin e dërsitur. E shoh unë që ti u bërë telef në punë.

Normistja nuk e zgjati më tej; u largua. Alfredi u ul mbi një dërrasë dhe ndezi një cigare. Unë nuk i fola. E dija se ç'përgjegje mund të më jepte.

Kolektivi i brigadës vendosi që t'i paguheshin Alfredit të 27 orët që kishte munguar në punë. Ky veprim e vuri në mendime.

— Si thua ti — më pyeti mua, — përse ma bëri brigada këtë lëshim?

— Sepse të kanë shok — i thashë unë.

Nuk foli. Vazhdoi përsëri punën, i kredhur në mendime.

* * *

Shpeshherë vinte dhe takohej me Alfredin një shok i tij, që quhej Ylli, një djalosh i ri në moshën e Alfredit. Kur erdhi në fillim Ylli, u takua me mua gjithë përzemërsi dhe vazhdimisht fjalët i shoqëronte me buzëqeshje. Pastaj e lokalizoi bisedën vetëm me shokun e tij. Alfredi nxori paqetën t'i japë një cigare.

— Si është? — pyeti Ylli duke marrë cigaren. Mua më kapi syri vështrimin e tij, të drejtuar nga ana ime.

— I shtë, — u përgjegj Alfredi.

Pa ditur se si qe lidhur shoqëria e tyre, se ç'më shtynte të mendoja se kishte diçka jo të mirë. Kur vinte Ylli, Alfredi e priste me qejf, se ç'ngatërronin së bashku dhe, kur ikte, ndihmësi im egërsohej. Patjetër, në këto raste, do të vriste ndonjë gisht gjatë punës, ose do t'i binte llaç në sy.

Një ditë Alfredit i mbylleshin sytë për gjumë. As ngacmimeve të mia nuk u përgjegjej, aq e kishte humbur. Nga mbasditja vonë erdhi edhe Ylli. Sa e pushë, një mendim i keq më lindi në vete. Dje ai erdhi dhe ndejti gjatë duke biseduar me Alfredin, derisa unë i tërhoqa vëmendjen ndihmësit tim. Ylli tha se atë ditë merрте rrogën dhe unë mendova se do të shkonin të kthenin ndonjë gotë me Alfredin. Edhe kjo nuk më pëlqeu, por nuk bëra zë. Kurse të nesërmen e asaj dite Ylli erdhi përsëri i ngrehur dhe i kapardisur me një kostum të ri. Ndërsa Alfredit i varej koka nga pagjumësia, Ylli ishte fare i freskët.

— Nuk paske vajtur në punë sot, ti, Ylli? — E pyeta.

— Ja, nga puna vij tani.

— Dje ti the se punoje turnin e dytë?

Fredit padashur i shpëtoi një e qeshur e lehtë tallëse: — Ngeci karkaleci.

Yllit ju skuq maja e hundës si spec.

— Ikë, more, shok i poshtër, — ja plasi Ylli. Alfredi as e mori mundimin t'i kthejë për-

gjegje: E ngriti dorën dhe ja tereziti mistrinë në kokë, por Ylli ju shmang dhe mistria përfundoi dy copash në çimento. Dëshën të përlesheshin me duar, po nuk i lejova.

Më erdhi mirë që Ylli iku i zemëruar. Dëshiroja që ajo grindje të qe kapaku i shoqërisë së tyre. Si iku Ylli, Alfredi më tregoi se natën e kaluar kishin luajtur bixhoz së bashku me dy të tjerë. Ylli, që kishte qenë ortak me një tjetër, fitoi, kurse Alfredi me ortakun e tij kishin humbur të gjithë lekët. Atë e brente dyshimi se Ylli ja kishte fituar lekët me hile.

— Ti do të përfundosh në burg — i thashë me zemërim dhe pa e shikuar në sy. — Do ta bëj çështje në brigadë — theksova më vonë.

Pas një heshtje të gjatë dëgjova që tha i vendosur: — I dhashë fund asaj pune tani më. Ishte hera e parë që merrte zotim.

Vendosa ta lë në heshtje këtë çështje.

* * *

Dalëngadalë Alfredi zuri të shtrohej e të mos i përtonte punës. Mungesave u vuri kapakun. Edhe ndaj meje mbante një qëndrim shumë miqësor. Bashkë rrinim shumë herë, shkonim në kinema, në teatër, në shtëpi i kisha vajtur dhe më kishte ardhur. Dhe unë mendoja se kjo shoqëri do të vinte duke u forcuar gjithnjë e më shumë. Por isha gabuar.

Kisha disa ditë që po merresha me përgatitjen e projektdiplomës dhe atë të dielë të 24 qershorit kisha vendosur ta përfundoja, sepse të ne-

sërmen duhej ta dorëzoja. Ishte pothuaj ora katër e gjysmë kur erdhi Alfredi. Kishte veshur një palë pantallona gri, një këmishë silon të bardhë, çorape dhe këpucë gri. Flokët, si gjithnjë, i kish-te ulur mbi ballë. Sa herë isha munduar t'i mbush-ja mendjen se flokët do t'i shkonin më mirë po t'i krihte përpjetë, po nuk kisha mundur. Pantallonat, megjithëse pak të ngushta, nuk i ngarkonte me zinxhirë.

— Qenkërke i zënë ti, Lirim? Unë kam marrë katër bileta për të shkuar në kinema.

— Shumë mirë ke menduar ti, Fredi, por, siç e sheh edhe vetë, kam shumë punë.

— Sidoqoftë sot do të vemi në kinema, — u fut në bisedë Afërdita, e cila së bashku me Elzën kishin hyrë në dhomë pas Alfredit.

Unë nuk u vura rëndësi fjalëve të saj dhe po merresha me punën time, ndërsa ata të tre po prisnin në këmbë.

— Epo, e lemë këtë gjeometrin e ardhshëm të merret me diplomën, se po i zien koka dhe shkojmë ne të tre — foli përsëri Afërdita.

— Po, ju shkoni — thashë unë duke hequr vazhdimisht vija në letër.

Edhe Alfredi ishte i gatshëm që të shkonin të tre, kurse Elza sikur e kishte pa qejf. Më në fund ju mbush mendja dhe asaj dhe ata shkuan të tre në kinema. Sapo u mbyll dera, unë i harrova fare ata dhe u zhyta i tëri pas projekt-diplomës.

Kishte kaluar më tepër se një gjysmë ore, kur te dera e dhomës sime u duk nëna, që sapo kishte ardhur nga dyqani.

— Lirim, ku është Afërdita? — Më pyeti.

Kur i tregova se kishte shkuar në kinema me Elzën dhe Alfredin, ajo mblodhi buzët:

— Si shumë fushë të lirë po i lejon atij Fredit. Po... nejtse, ti je i mençur vetë dhe di t'i peshosh punët mirë.

Kur erdhën Elza me Afërditën, unë e kisha mbaruar detyrën e shkollës. Isha i bindur se e kisha përgatitur mirë dhe rrija i shkujdesur. Nëna kishte rënë për të fjetur.

— E, moj, ç'film ishte ai? — I pyeta.

— Më mirë na pyet për përshtypjet që na la shoku yt — tha Elza me nervozizëm. — Nga e paske gjetur atë fundërinë?!

Sa dëgjova këto fjalë, më shkoi një e rrëqethur në trup.

— Pse si është puna? — Nuk më durohej derisa të dëgjoja se ç'kishte ndodhur.

Në fillim të shfaqjes së filmit Alfredi qe treguar i matur dhe i urtë. Mirëpo, mbasi kishin kaluar rreth 20-30 minuta, kishte filluar të lëvizë.

Gjoja si pa dashur kishte prekur dorën e Afërditës. Ajo e kishte hequr dorën duke u rrëqethur. Elza e kish vënë re, por s'e kish bërë veten, megjithëse e tronditur, s'e kish ndjekur dot filmin më.

Isha ngritur më këmbë si i dalldisur dhe nuk dija çfarë të thosha. Unë e quaja shok dhe përpigështa ta afroja edhe pranë familjes sime, pranë njerëzve të mi, ndërsa ai sillej në mënyrën më të ulët. I rrihja mendimet në të gjitha drejtimet dhe përfundoja se isha unë fajtori, unë, që gënjeja veten se Alfredi, ai rrugaç e vagabond mund të ndreqej...

— Lirim, do të më përcjellësh deri në shtëpi — më tha Elza.

— Mirë — dhe dola bashkë me të.

— Shiko, ki një gjë parasysh — më vuri në dukje Elza kur u gjendëm përjashta, — se Ditka nuk është indiferente ndaj Alfredit. Ajo u skandalizua më shumë nga veprimi i tij prej rrugaçi.

— Të ka thënë gjë ty?

— Jo, po janë gjëra që nuhaten nga një lëvizje, nga një gjest, nga një vështrim... Prandaj, i fejuari im i dashur — vazhdoi si me shaka dhe me ironi, — ruaje më shumë motrën tënde të vetme dhe mos e njih me këdo, sidomos me një rrugaç si Alfredi.

Ndërsa Elza fliste, unë vetëm kruaja kokën. E ndjeja veten fajtor.

* * *

Qysh të nesërmen e asaj dite vendosa që të mos punoj më me Alfredin. Ai sikur donte të afrohej, sikur kishte diçka që donte ta sqaronte me mua, por unë nuk i krijoja rast që të më fliste. Të gjithë shokët e brigadës çuditeshin që unë ngulja këmbë të mos punoja më me ndihmësin tim, dhe donin të mësonin se cili ishte shkaku i kësaj këmbëngulje. Brigadierit e kishte pyetur Alfredin dhe ai ja kishte treguar drejt se ç'kishte ndodhur. Mbas kësaj brigadierit u orvat për ta zgjidhur ngatërresën, po unë nuk pranoja në asnjë mënyrë.

As që doja t'ja dija fare për ato që thoshte brigadierit. Unë i kisha ndjerë pasojat e shoqërisë me Alfredin. Brigadierit, teknikut të objektit dhe gjithë të tjerëve mbase nuk u rëndonte kjo punë sa

mua. «S'e kanë provuar në kurrizin e tyre — thosha — prandaj mendojnë ashtu. Në të njëjtën mënyrë mendoja edhe unë në fillim, po ja ç'na doli. Edhe ata do të binden për këtë, do të vijë koha që do të më japin mua të drejtë». Dhe sa herë që shikoja Alfredin, këto mendime më turbullonin dhe më ndiznin gjakun. Nuk mbaj mend, deri atëhere, të kem urryer njeri aq shumë.

Një natë, kur shkova vonë në shtëpi, (kishim pasur një mbledhje në kantier që shkoi shumë gjatë) gjeta një vajzë me flokë të verdha rreth katërbëdhjetë vjeçe, që po rrinte me Afërditën. Vajza, sa më pa, u çel në fytyrë dhe më përshëndeti me përzemërsi. Atëherë e njoha: ishte Ermira, motra e vogël e Alfredit. Prania e saj më çuditi pa masë, sa që mbeta i heshtur dhe nuk dija ç'të thoja. Mendime të ndryshme më silleshin në kokë dhe më turbullonin arësye.

— Ka ardhur të pyesë për Alfredin — më tha Afërdita. — E ëma është shqetësuar shumë nga kjo vonesë.

— Të ishte vonuar më parë, ndërhyri Ermira, nuk do të na bënte përshtypje. Ishim mësuar me vonesat e tij. Nganjëherë nuk vinte fare gjatë gjithë natës. Po tani ndryshon puna. Ka kohë që ai është bërë i rregullt, nuk vonohet më. Edhe rrogën tani ja jep mamasë. Ne, të them të drejtën, u shqetësuam shumë sonte, menduam se mos filloi përsëri nga e para...

— Jo, jo, kishim punë — ja preva unë thatë.

— Do të jeni lodhur shumë, atëhere — foli përsëri Ermira.

— Jo, nuk jam lodhur, mbledhje kishim, por e zgjatëm shumë.

— Po Alfredi ishte në mbledhje?

Merret me mend se sa ngushtë u zura. Duhet të flisja për Alfredin, të cilin nuk doja ta shikoja me sy. Mirëpo, nuk mund të mos i përgjegjesha. Ajo më shikonte drejt e në gojë.

— Ishte, posi.

Atëhere u kujtova se kishim mbetur të tre më këmbë. I ftova që të ulen.

Po rrija e kundroja Ermirën. Më pëlqeu shumë kjo vajzë. Më pëlqeu sjellja e saj, arësyetimet e thjeshta, fytyra e pastër dhe e qeshur dhe sytë e saj që më shikonin gjithë dashamirësi.

— E di sa shumë ju çmon Alfredi? — M'u drejtua përsëri Ermira.

— Po ta dish ama se ç'thotë Lirimi për Alfredin? — Hyri përsëri në bisedë Afërdita.

Ermira e prekur e shikoi me vëmendje.

— Pse, prapë nuk shkon mirë atje në punë? — M'u kthye mua.

Rashë në prehërin e kësaj bisede të papëlqyer.

— Jo, se mirë, mirë punon, — thashë duke dashur që të mbyllej sa më parë kjo bisedë.

— Fredi s'të heq nga goja — tha përsëri Ermira — edhe mamaja të falënderon shumë. Ajo më porositi të të ftoj të na vish përsëri nga shtëpia, se ke shumë kohë që nuk ke dalë. Ajo ju do shumë dhe thotë se ju e keni shpëtuar Fredin. Para ca ditësh, kur takoi Fredin me Afërditën në rrugë, dhe, kur mori vesh se Afërdita qe motra jote, nuk përmbahej dot nga gëzimi.

Kjo ishte mbrëmja e çudive për mua. Vura re Afërditën, që rrinte si e ngrirë.

Motra ime shoqërohej përsëri me Alfredin. Motra e Alfredit erdhi në shtëpinë time. Nëna e Alfredit më ftonte në shtëpinë e saj...

Po tani, si t'ja bëja? Ç'duhej bërë?

* * *

Alfredi erdhi e më kërkoi falje. Këtë barrë të rëndë ja lehtësova pak edhe unë. Aty pranë u ndodh edhe xha Zeneli, një karpentier, i cili e dinte arësyeën e prishjes sonë... Xha Zeneli u afrua dhe ndërhyri në bisedë. Nuk ja tha hapur. Por, me shumë takt e me shprehje popullore plot nëntekst, i dha të kuptojë sa i neveritshëm bëhet njeriu për shoqërinë, kur keqpërdoron besimin e shokut të vet.

Alfredit i vinte rëndë të më shikonte në sy. Ndjenja edhe urrejtje edhe keqardhje për të. Nuk mund ta merrja kurrë me mend se do të ndryshonte aq shumë. E kuptova se kishte shumë nevojë për ngrohtësi shoqërore. Kjo që arësyeja që më shtyri ta harroja të keqen. Ngjante me një fëmijë që, mbas një paralize të gjatë, sapo fillon të ecë. Pranova të punoj përsëri me Alfredin dhe në punë, dalëngadalë, miqësia jonë filloi të përtërihej. Unë kisha kurdoherë kujdes që të mos tregohesha i rezervuar, sikur midis nesh nuk kishte ndodhur asgjë dhe shikoja se kjo e detyronte të sillej me aq korrektesë kundrejt meje, sa nuk i shkonte fare temperamentit të tij.

Dhe tani besoj se erdhi fundi i këtij tregimi. Pas kësaj mund t'u lindë pyetja se si përfunduan marrëdhënjet e Alfredit me Afërditën. Po t'u tregoj më gjatë kam frikë se do t'u mërzis. Më mirë gjejeni vetë.

KUR GRATË RRAHËN SAZET KËSHILLI HOQI VALLEN...

Sipas Ademit, nënkryetarit të këshillit popullor të fshatit, tersllëku nisi të martën, tri ditë më parë, kur i doli përpara Anifja, nusja e fqinjit. Atë mëngjez ai kishte marrë udhë për nga arat e sipërme të kooperativës dhe i qe shkrepur ta ndizte një herë rrëzë një qershie. U shtri te rrënja e pemës, drodhi ngadalë një cigare të trashë, pastaj, duke thithur me etje duhanin, nisi të sodiste fshatin përballë. Dy lagjet e fshatit dukeshin si në pëllëmbë të dorës. Tutje, mes pemish-teve, lëviznin kooperativistët, të cilët po ngrinin muret e shkollës së re. Poshtë, afër lumit, shkëlqenin tjegullat e kuqe të stallës së madhe të lopëve. Më tej, dy brigada ishin përhapur në parcelat dhe, nga lëvizjet e tyre, dukej se po prashisnin. Një qetësi e këndshme zotëronte te bregu ku prehej nënkryetari.

Papritur, te udha në breg, u dëgjuan zëra dhe e qeshura e një gruaje. Ademi zgjati kryet. Katër gra, të ngarkuara me bucela në shpinë e duke thurur çorape, po i ngjiteshin së përpjetës për të shkuar te burimi, nja dy kilometra mbi fshatin.

Ajo që qeshte ishte Anifja. Diç u pëshpëriste të tjerave, dhe ato përpiqeshin ta mbanin gazin.

«Ç'dreq më doli përpara syve që në mëngjez», shfryu Ademi dhe rrudhi vetullat. Këto vitet e fundit nusen e fqinjit e kishte marrë inat. Inat kishte edhe nja gjashtë gra të tjera të fshatit të cilat kishin filluar të fushnin hundët gjer në punët e këshillit. Ato harronin se ishin gra, dhe nëpër mbledhje flisnin si t'u shkrepëj, pa pyetur as për burrat, as për brigadierët e anëtarët e kryesisë e të këshillit. Veç nga të shtatë gratë Anifen nuk e duronte fare. Një pëllëmbë njeri ishte, por zevzeke e madhe. Ngrihet e bijë e botës e, si pa gjë të keq, ja thotë copë kryetarit të këshillit për t'ja hequr së shoqes veshjet e rënda të malësisë. Bile, një vit më parë, megjithëse me marifet, ajo ja prishi edhe të vjehërrit, i cili nguronte të jepte fjalën për të shkurtuar kopshtin personal. Ademi kishte vënë duart në kokë: s'ishte parë e dëgjuar gjer atëhere që të ngrihej në mbledhje nusja kundër vjehërrit! Dhe i shoqi, në vend që t'ja mblidhte një herë e mirë gruas, kishte marrë anën e saj. Phë, ç'burrë!

Ç'është e vërteta, nuk ishte ky shkaku kryesor që nënkryetari nuk donte ta shihte me sy fqinjën. Pak punë i prishte atij nëse Anifja ishte bërë gjel në shtëpinë e burrit. Fundi i fundit, i shoqi atë kokë kishte, atë qylaf le të mbante, — thosh Ademi. Ai e kishte hallin gjetiu. Fqinja kishte filluar të rrinte shpesh me nusen e djalit të tij. Kjo e mbushte me maraz dhe, saherë i shihte kokë më kokë, i ndizej gjaku, sepse kot nuk thonë se, po ju afrove shumë zjarrit, do të

përcëllohesh. Nja dy herë i kishte shfryrë së resë dhe kjo sikur i kishte rralluar muhabetet me fqinjën, po nënkryetari e kishte kuptuar se sado që po përpiquej, nuk i shpëtonte dot asaj laneteje. E si mund ta largonte të renë nga Anifja, kur të dyja punonin në kooperativë e, si të mos mjaftonte kjo, sot, mbledhje këtu për punë të fshatit e të kooperativës, nesër mbledhje atje për emancipimin e gruas. Dhe fqinja, si për inat të nënkryetarit, jo vetëm që s'mungonte, por zinte vend gjithnjë pranë së resë së tij. Pastaj edhe mbledhjet kishin filluar t'ja prishnin gjakun Ademit. Më parë s'kishin thënë ndonjëherë fjalë të këqia për të, kurse tani...

Nënkryetari nuk e harronte kurrë atë mbrëmje. Ajo kishte nisur për bukuri dhe ashtu do të mbaronte, sikur të mos kishte hapur gojën fqinja. Në atë mbledhje ajo e teproi shumë. Qe ngritur papritur dhe, pa marrë leje, ishte zbrazur:

— S'po e marr vesh punën e këshillit të katundit tonë... Shumë na keni folur për emancipimin, por çesmen nuk e keni sjellë në mes të katundit, siç është marrë vendimi. Edhe të shurdhër të kishit qenë, bre burra, do ta kishit dëgjuar zërin tonë, aq fort kemi bërëtitur këta dy vjet.

Në shesh plasi zhurma. Ademi vështroi Anifen me inat. «Ej, ç'bela na ka pjellë me këtë!» — foli me vete. Çështja e çesmes qe ngritur nja dy herë në mbledhjet me popullin. Gratë ishin ankuar, sepse shkonin për të mbushur ujë te burimi larg fshatit. Nënkryetari, për t'ja mbyllur gojën fqinjës, i ra shkurt:

— Lëre këte muhabet, Anife, se kemi boll halle të tjera për të pleqëruar.

— Edhe puna e çesmës hall është, axhë Adem, — ju përgjegj aty për aty Anifja.

Ademi u ngrys. U zu ngushtë. Nisi të mendonte si t'i përgjigjej, por e ndihmoi Selimi, miku e moshatari i tij:

— Mirë, mirë. E morëm vesh ku e ke hallin, oj nuse!

— Unë dua ta marrin vesh edhe ata të këshillit, — nguli këmbë ajo.

Zhurma u bë akoma më e madhe. Dikush zuri edhe të qeshte. Pastaj, kur qetësia nisi të vendosej përsëri, u dëgjua zëri i Ademit, që po i thoshte Selimit:

— Për bela vijnë gratë në mbledhje. Ato vetëm të llapin dinë.

Anifja, që gjer në atë çast kishte qëndruar e qetë, u skuq e tëra dhe ju kthye nënkryetarit:

— Dy vjet më parë, ja, këtu, në këtë shesh burrash, faqe gjithë katundit, ju të kryesisë na dhatë fjalën se do të na sillnit çesmën. Gjer më sot s'jini tundur fare nga vendi, na kini mbajtur vetëm me fjalë. Le ta thotë katundi tani, o axhë, se kush po llap më shumë, ju të këshillit, apo ne gratë.

— Më të lumtë! — thirri dikush nga grumbulli i njerëzve.

— Folë, Anife, jepi edhe më fort, se ke të drejtë. — shtoi një tjetër.

Kryetari i këshillit brofi në këmbë.

— Mati fjalët, shoqja Anife, — bërtiti i prekur. — Këta dy vjet nuk i kemi kaluar duke u shë-

llehur në diell. Mjaft gjëra kemi bërë. Sa për çesmen, s'kemi pasur kohë. Kur t'i vijë radha, do të bëhet edhe ajo.

Nga grumbulli i njerëzve u ndie përsëri një murmuritje.

— Po, po, kur t'i vijë radha... — përsëriti Anifja me qesëndi. — Flisni kaluar ju, se ujët e gjeni gati në shtëpi. E di unë si e doni ju..., — dhe e la fjalën për gjysmë e mori frymë. Pastaj vijoi: — Atëhere do ta shikoni ju vetë axhë Ademin si do të vrapojë i pari gjer në qytet për të gjetur tubat. Po ç't'u bëj këtyre, që akoma... — dhe me kokë tregoi ato pak gra që kishin ardhur në atë mbledhje.

Nënkryetari i kërceu damari i ballit: «Heu, dashka të bëhet gjel edhe në katund!» Ai hodhi cigaren në tokë dhe u ngrit tërë inat. Por sekretari i partisë e kishte marrë fjalën më parë.

— Anifja ka të drejtë. Gjatë këtyre dy vjetëve, — po thoshte ai, — do të kishim gjetur kohë të sillnim jo një, po tri çesma në fshat.

Ademi ziente përbrenda. S'i durohej sa të mbaronte sekretari. Eh, si do ta vinte Anifen përpara, që ta merrte vesh i gjithë fshati se kush ishte Ademi! Po Selimi e kapi nga krahu, e përkuli pranë vetes dhe i foli diçka në vesh.

* * *

... Të katër gratë e ngarkuara me bucela në shpinë i ngjiteshin së përpjetës dhe përpiqeshin të mbanin gazin. Anifja diçka u thoshte. Ademi, rrzë qershisë, i vështronte vetullngrysur.

— Qyqja! — Thirri një nga gratë dhe qëndroi në vend. — Shikoni përpara! Po zbret sekretari i partisë me Shkëlzenin, atë vullnetarin nga qyteti. Sa turp që po na gjejnë të ngarkuara!...

Gratë ndaluan të gjitha. Sekretari me Shkëlzenin u afruan.

— Pa ardhur çesma në fshat, s'kemi si e mbajmë fjalën që të mos ngarkohemi me tërkuzë, moj Nexhmije, — u përgjegj gruaja e tretë. — Shtëpia do ujë...

— Po në shtëpi s'jeni vetëm ju gratë, — u tha sekretari, ndërsa po përshëndetej me to.

— Ata? — u hodh Nexhmija. — E marr me mend se ku do të qëllosh, o shoku sekretar. Por, s'para dëgjojnë mirë nga veshët burrat tanë për kësaj lloj punësh.

— Duket se edhe ju nuk keni thirrur fort, — ndërhyri me të qeshur Shkëlzeni. — Përse nuk u vini një fletërrufe të madhe shokëve të këshillit të fshatit dhe të kryesisë së kooperativës që s'po e vënë ujin në zjarr për problemet që shqetësojnë gratë?

Të nesërmen Ademi e kaloi tërë ditën në arat e kooperativës. Ishte i kënaqur, pasi nuk e kishte parë fytyrën e fqinjës. Në mbrëmje, tek rrinte në shtëpi, ju bë sikur dëgjoi zërin e saj në oborr. «Do të ketë ardhur t'ja ngatërrojë mendjen nuses së djalit. Për bela, edhe im bir këto ditë gjeti të shkojë me shërbim», — foli me vete.

Ditën e tretë gjer nga dreka s'ngjau gjë. U çudit vetëm se atë pasdite gratë u larguan shumë shpejt nga arat e kooperativës. Pak më vonë u larguan edhe të rinjtë e të rejtat. «Do të kenë mbledh-

je, — tha Ademi me vete, duke marrë udhën për në shtëpi. — Të paktën sot nuk do t'ja shoh fytyrën...»

Një orë më vonë, lajmi u përhap si rrufe, në të gjithë fshatin, bile përpara se nusja e të birit të kthehej nga mbledhja në shtëpi. Gratë në mbledhje paskëshin vendosur të mos shkonin për ujë te burimi, gjersa të mos ndërtohej çesma brenda në fshat.

Ademi çakërriti sytë:

— Mos kanë lojtur nga mendtë!.. Po ujë kush do të sjellë!

— Burrat, axhë Adem. Kështu vendosën gratë. S'ke ç'bën.

— Je në vete! Kësaj i thonë të ngresh krye!

Ademi rrëmbeu xhakëtën dhe u mat të dilte. Do të shkonte te sekretari i partisë. S'ishte parë e dëgjuar ndonjëherë që gratë të bëjnë me kokë të tyre:

— Mos u lodh kot, axhë Adem, të shkosh te sekretari. Organizata e partisë sapo bëri mbledhjen e saj. Ajo vendosi të mbështetë gjer në fund vendimin e grave. Edhe rinia atë punë bëri. Ndaj ktheu, bëj gati bucelën e tërkuzën, sa s'është kthyer djali nga shërbimi.

— Unë?! Hëm!..

Ndaj të ngrysur Ademi çkrofëtinte në oborr. Ishte ulur mbi një trung, mbante në dorë një shkop, thithte thellë cigaren dhe herë pas here i bërtiste së resë:

— Shko për ujë, se u ngrysur fare! S'ka ç'më duhet mua se ç'keni vendosur ju gratë!

— Mirë, o baba. Po ju, kur merrni vendime, a i kryeni?

— Mjaft! Mjaft! Po pse, unë do të shkoj të mbush ujë?!

— Unë e thashë në mbledhje se ti je i mocëm, por më thanë se axhë Ademi është shëndoshë si molla.

— E di unë kush i bën të gjitha këto punë!.. Ajo lanetja!..

Më kot u mundua Ademi, herë me të bërtitur herë me të mirë t'ja mbushte mendjen së resë që të shkonte te burimi. Pastaj u lodh dhe zuri të vështronte gjelin afër kotecit, që po çukiste një koçan misri. Nja dy pula ju afruan koçanit. Gjeli ngriti kokën, shpupuriti pak krahët dhe pulat u larguan të trembura. Gjeli lëvizi i kënaqur rrotull koçanit, ktheu kokën nga Ademi, e vështroi me njërin sy, pastaj ktheu edhe anën tjetër të kokës dhe e vështroi edhe me syrin tjetër. Së fundi, vuri këmbën mbi koçanin e misrit dhe lëshoi një zë si të ngjirur, sikur deshte t'i thoshte nënkryetarit: «Ja, unë jam gjel»...

— Tphu! — shau Ademi dhe e goditi gjelin me shkop.

— Mirë mbrëma, o i zoti i shtëpisë! A pret miq?

— Urdhëroni! — Ademi u përpoq t'u buzëqeshë dhe, ndërsa po ngjite shkallët, ja bëri me shënjë së resë që të vraponte gjer te burimi. E reja i tundi kokën në shënjë mohimi.

Ato dhjetë minuta që kaloi me mysafirët, Ademi ishte i turbullt, sa nuk mbante mend çfarë u tha e çfarë i thanë.

— Mos je pa qejf? — e pyeti sekretari.

— Jo. S'kam gjë.

— Të shoh sikur je në siklet. Ç'ke?

Ademi e pa në sy. E kuptoi përse kishin ardhur sekretari i partisë me vullnetarin nga qyteti. «U pa kjo punë», foli me vete dhe u ngrit.

— Do të më falni, o shokë, se po shkoj të mbush ujë te burimi.

— Shumë mirë. Po vijnë edhe ne me ty. Thuaj nuses të na japë edhe neve nga një enë.

Xha Ademi sikur u çlirua nga një peshë e rëndë. Me sekretarin e partisë sikur nuk ndjente aq turp të kalonte mes fshatit për të mbushur ujë. Nënkryetari nxori mushkën dhe bëri gati litarin për të lidhur bucelat.

— Pse, o Adem, nusja me mushkë e mbushte ujin? — foli sekretari.

Ademit i mbeti dora në samar, lëvizi dy-tri herë supet dhe belbëzoi:

— Se mos ja mbajti njeri... Po mirë ma punuat...

* * *

Të nesërmen në mëngjez Ademi doli nga shtëpia që pa gdhirë. Donte të shkonte te kryetari i këshillit, po dhe ai kishte dalë pa aguar mirë e kërkonte Ademin. Më poshtë takoi edhe anëtarët e tjerë të kryesisë. Tek bisedonin, vunë re Anifen, që po i vështronte buzëgaz.

— Kështu, Adem, ti nisu që sot në qytet bashkë me Shkëlzenin dhe do të interesoheni për tubat. Ne të tjerët do të ndajmë punët e këtushme. Shiko, mbaroni punën sa më parë, e mos u vononi.

— Mos ki frikë se nuk vonohen, shoku kryetar — foli Anifja. Axhë Ademi do të mbarojë punë shumë shpejt, pasi tani ai e di ç'do të thotë të mbushësh ujë te burimi larg fshatit.

Ademi tundi kryet e tha si me vete:

— Mor po ç'i do llafet, na tunde të gjithë.

— Jo unë, po partia dhe e drejta, — u përgjegj Anifja.

RENDITJA E TREGIMEVE

	Faqe
Unë, Habibi dhe brigadieri	3
Nyja e djegur	10
Trau i fundit i soletës	20
Shatërvani i prishur	28
45 minuta mbi çati	46
Hall me tullat e bardha	53
Brigada e shakaxhirjve	59
Ndihmësi im	69
Kur gratë rrahën sazet, këshilli hoqi vallen... ..	84